

UNIVERSITETI I EVROPËS JUGLINDORE
УНИВЕРЗИТЕТ НА ЈУГОИСТОЧНА ЕВРОПА
SOUTH EAST EUROPEAN UNIVERSITY



FAKULLTETI JURIDIK
ПРАВЕН ФАКУЛТЕТ
FACULTY OF LAW

STUDIME POSTDIPLOMIKE - CIKLI I DYTË

Teza:

**“E DREJTA E PRONËSISË INTELEKTUALE DHE
NDRYSHIMET KLIMATIKE”**

KANDIDATI:

Aida Musa

MENTORI:

Doc. Dr. Sami Mehmeti

Tetovë, 2020

Deklaratë

Unë Aida Musa deklaroj me përgjegjësinë më të lartë se jam autore e këtij disertacioni, puna e raportuar këtu ka përbërje tërësisht origjinale dhe nuk përmban punën e personave të tjerë pa u cituar. Bibliografia e shënuar përmban të gjithë literaturën që kam përdorur në shkrimin e disertacionit, dhe se të gjitha referencat i referohen kësaj bibliografie. Informacioni i marrë nga puna e botuar ose e pa botuar e të tjerëve është e cituar në tekst dhe referencat janë shënuar në listën e burimeve. Unë e kuptoj që çdo shkelje e këtyre rregullave do të konsiderohet mashtrim dhe do të ketë pasoja juridike.

Abstrakt

Në këtë punim të magjistraturës në fillim do të trajtohen njohuri të përgjithshme në lidhje me “Ndryshimet Klimatike”, do të sqarohen ndikimet e njeriut në ndryshimin e klimës si dhe pasojat që ka sjellur ajo. Për të pasur një pasqyrë më të qartë do të analizohet dhe studiohet mekanizmi i efektit të serrë dhe efektet e rrezatimit diellor. Do të parashtrihen të gjitha përpjekjet për ambient të pastër dhe përpjekjet për të ulur ngrohjen globale duke zvogëluar emetimet e gazrave serrë në Republikën e Maqedonisë së Veriut dhe në vendet tjera të botës. Më pas do të flitet për pronësinë intelektuale duke paraqitur nocione, të drejtat që dalin nga pronësisë intelektuale dhe termat që mbrohen nga të drejtat e pronësisë intelektuale. Vecmas flitet për secillën duke i dhënë theks të vecantë patentave, pasi patentat janë të drejta që merren me mjedisin, sepse ato mbrojnë shpikjet që mund të kenë ndikim negativ në mjedis siç janë makinat e reja, aeroplanët, trenat dhe më përgjithësisht produktet ose proceset që gjenerojnë CO. Në vazhdim, do të paraqiten mekanizmat ndërkombëtarë që rregullojnë përdorimin e pronësisë intelektuale në çështjet që lidhen me ndryshimet klimatike, përpjekjet e konventave, protokolleve dhe organizatave të cilat merren të drejtat e pronësisë intelektuale në raport me problemet e ndryshimeve klimatike.

Autorja beson se me teknologjinë e gjelbërt, të cilës i kushtohet shumë vëmendje me qëllim që të korigjohen ndikimet negative të njerëzve që vazhdimish po i paraqesin në tokë, do të mundësohet përsëri të jetojmë jetë të shëndetshme dhe mënyrë të pastër jetese dhe më të gjelbër. Pasi me anë të saj mundësohet riciklimi dhe menaxhimi i mbeturinave, menaxhimi i djegies së mbeturinave, mundësohet pastrami i ujit, pastrim i ajrit, nga fabrikat dhe automjetet të cilat vazhdimisht e ndotin me karbon. Teknologjia e gjelbër do të mundësojë që njerëzit dhe gjallesat e tjera të marrin sërish frymë sic duhet.

Fjalët kyçe: Ndryshimet klimatike, Gazrat Serrë, Ndikimet e ndryshimit të klimës, Pasojat e ndryshimit të klimës, Pronësia intelektuale, Patentet, E drejta e autorit (copyright) dhe të drejtat përkatëse, Markat tregtare (trademarks), Dizajni industrial, Sekretet tregtare, Teknologjitë pastërta (green technologies), Teknologjitë që mundësojnë gjenerimin e energjisë së ripërtitshme, Qasja dhe transferimi i teknologjive.

Абстракт

Во оваа магистерска теза, на почетокот, ќе се третираат општите знаења поврзани со „Климатските промени“, ќе се објаснат влијанијата на луѓето во климатските промени, како и последиците што ги донесе. За да имаме појасна слика, ќе се анализира и проучува механизмот на ефектот на стаклена градина и ефектите од сончевото зрачење. Истотака ќе се направат сите напори за чиста животна средина и напорите за намалување на глобалното затоплување со намалување на емисиите на стакленички гасови во Република Северна Македонија и во другите земји во светот. Потоа ќе се дискутира за интелектуалната сопственост, воведувајќи поими, права на интелектуална сопственост и поими заштитени со права на интелектуална сопственост. Одделно ќе се зборува за секој но со посебен акцент на патентите, бидејќи патентите се права што се однесуваат на животната средина, бидејќи тие штитат пронајдоци што можат да имаат негативно влијание врз животната средина, како што се нови автомобили, авиони, возови и генерално производи или процеси што создаваат CO². Во следното, ќе бидат презентирани меѓународните механизми што ја регулираат употребата на интелектуална сопственост во прашања поврзани со климатските промени, ќе бидат презентирани напорите на конвенциите, протоколите и организациите кои се занимаваат со правата на интелектуална сопственост во врска со прашањата за климатските промени.

Авторот верува дека со зелената технологија, на која многу внимание се посветува, со цел да се поправат негативните влијанија на луѓето кои постојано ги презентираат на земјата, повторно ќе можеме да живееме поздрав живот и почист и позелен начин на живот, бидејќи тоа овозможува рециклирање и управување со отпад, управување со согорување на отпад, овозможува прочистување на водата, прочистување на воздухот од фабриките и возилата кои постојано го загадуваат амбиентот со јаглерод. Зелената технологија ќе им овозможи на луѓето и другите живи суштества повторно да дишат правилно.

Клучни зборови: Климатски промени, стакленички гасови, влијанија врз климатските промени, последици од климатските промени, патенти на интелектуална сопственост, авторски права и сродни права, трговски марки, индустриски дизајн, трговски тајни, зелени технологии на технологии, технологии што овозможуваат производство на обновлива енергија, пристап и трансфер на технологиите.

Abstract

In this master's thesis, at the beginning, general knowledge related to "Climate Change" will be treated, the human influences on climate change will be explained, as well as the effects it has brought. To have a clearer picture the mechanism of the greenhouse effect and the effects of solar radiation will be analyzed and studied. All efforts for a clean environment and efforts to reduce global warming by reducing greenhouse gas emissions in the Republic of Northern Macedonia and in other countries of the world will be made. After that Intellectual property will be discussed, introducing notions, intellectual property rights and terms protected by intellectual property rights. The author will separately talk about each with a special emphasis on patents, as patents are rights that deal with the environment, because they protect inventions that can have a negative impact on the environment such as new cars, airplanes, trains and generally products or processes that generate CO. In the following, international mechanisms governing the use of intellectual property in matters related to climate change, the efforts of conventions, protocols and organizations that deal with intellectual property rights in relation to climate change issues will be presented.

The author believes that with green technology, to which much attention is paid in order to correct the negative impacts of people who are constantly presenting them on earth, we will again be able to live healthier lives and cleaner and greener lifestyles. As it enables recycling and waste management, waste incineration management, enables water purification, air purification, from factories and vehicles which constantly pollute it with carbon. Green technology will enable humans and other living things to breathe properly again.

Keywords: Climate change, Greenhouse gases, Climate change impacts, Effects of climate change, Intellectual property Patents, Copyright and related rights, Trademarks, Industrial design, Trade secrets, Technologies green technologies, Technologies that enable the generation of renewable energy, Access and transfer of technologies.

Përmbajtja	
Hyrje.....	8
Kapitulli I - Ndryshimet klimatike	9
1.1 Baza shkencore: Ngrohja globale si pasojë e efektit të serrës	9
1.1.1 Përkufizimi i ndryshimit të klimës	11
1.1.2 Mekanizmi i efektit të serrë	12
1.1.3 Efektet e rrezatimit diellor	14
1.1.4 Ndikimet e njeriut në ndryshimin e klimës	15
1.1.5 Pasojat e ndryshimit të klimës	17
1.1.6 Përpjekjet për ambient të pastër dhe përpjekjet për të ulur ngrohjen globale duke zvogëluar emetimet e gazrave serrë në RMV dhe në vendet tjera të botës	18
1.2 Ndikimet e ndryshimit të klimës	23
1.2.1 Ndikimi i ndryshimit të klimës në burimet (resurset) ujore	23
1.2.2 Ndikimi i ndryshimit të klimës në shëndetin publik	24
1.2.3 Ndikimi i ndryshimit të klimës në bujqësi	27
1.2.4 Ndikimi i ndryshimit të klimës në sektorin e energjisë.....	28
1.2.5 Ndikimi i ndryshimit të klimës në ekosistemet dhe biodiversitetin	29
Kapitulli i II - Pronësia intelektuale.....	31
2.1 Nocioni i pronësisë intelektuale	31
2.2 Pronësia intelektuale si mekanizëm i interesit publik	34
2.3 Pronësia intelektuale dhe të drejtat e njeriut	35
2.4 Roli i pronësisë intelektuale në zhvillimin ekonomik	35
2.5 Struktura themelore e pronësisë intelektuale ne RMV	36
2.5.1 Patentet.....	37
2.5.2 E drejta e autorit (copyright) dhe të drejtat përkatëse	39
2.5.3 Markat tregtare (trademarks)	40
2.5.4 Dizajni industrial	41
2.5.5 Sekretet tregtare	42
Kapitulli i III - Mekanizmat ndërkombëtarë që rregullojnë përdorimin e pronësisë intelektuale në çështjet që lidhen me ndryshimet klimatike	43
3.1 Organizata botërore për pronësi intelektuale, WIPO GREEN	43

3.2 Organizata botërore e tregëtisë(WTO): Marrëveshja për aspektet tregtare të pronësisë intelektuale (TRIPS)	46
3.3 Konferenca e Kombeve të bashkuara për mjedisin jetësor dhe zhvillimin (“EarthSummit”), në Rio De Zhaniero, 1992	49
3.4 Konventa kornizë e Kombeve të bashkuara për ndryshimin klimatik (UNFCCC) 1992.....	52
3.5 Protokoli i Kyotos, 1997.....	53
Kapitulli i IV -Raporti mes pronësisë intelektuale, teknologjisë dhe ndryshimeve klimatike.....	55
4.1 Pronësia intelektuale dhe teknologjitëe pastërta (green technologies).....	55
4.2 Teknologjitë që mundësojnë gjenerimin e energjisë së ripërtitshme.....	58
4.3 Qasja dhe transferimi i teknologjive relevante për ndryshimet klimatike.....	60
4.4 Roli i Financës së gjelbërt në mbrojtjen e mjedisit në Republikën e Maqedonisë së Veriut dhe në Kosovë.....	62
Kapitulli i V	65
Hulumtimi empirik.....	65
Përfundime dhe rekomandime	69
Bibliografia	72

Hyrje

Problemi i ngrohjes globale është dhe gjendet kudo. Kjo temë jo vetëm që mbush faqet dhe ekranet e të gjith mediave si p.sh: televizorëve, të gazetave, filmave etj. Ajo gjithashtu rregullisht dhe gjithnjë e më shumë shfaqet dhe shqetëson edhe ekonomistët, juristët, biznesmenët, kompanitë private, shkenctarët dhe politikanët. Ngrohja globale është shkaktuar kryesisht nga rritja e dioksidit të karbonit (CO₂) në atmosferë, mirëpo e gjithë kjo mund të thuhet se është shkaktuar si rezultat i aktivitetit njerëzor.

Revolucioni industrial ka sjellë me vete të drejtat e pronësisë intelektuale, ndër më të rëndësishmet nga të cilat është e drejta për të mbrojtur shpikjet. Dhe qëllimi kryesor i ligjit për patentat është të japë një nxitje për shpikësit për të shpikur produkte, procese dhe makina të reja. Mirëpo përveç që ligji duhet të mbroj shpikësit, ai gjithashtu duhet të u jap kushte dhe rrethanat në të cilat mund të realizohet kjo veprimtari. Nga gjithë kjo që u tha, mund të shtrohet pyetja: a mund të jenë të drejtat e pronësisë industriale (PI) shkaku i ngrohjes globale?¹

Disa nga shpikjet më të mëdha në shekujt e fundit përfshijnë makinën, trenin, aeroplanin dhe kompjuterin.² Për t'i vënduar ne funksion mjetet e lartpërmendura duhet të përdoret energjia, përgjithësisht qymyri dhe nafta. Këto janë disa nga shkaqet që kontribuojnë në rritjen e dioksidit të karbonit në atmosferën e planetit. Bashkimi Europian si një prej faktorëve kryesorë të rritjes së CO₂ e paraqet transportin. Komuniteti akademik deri më tani i ka kushtuar shumë pak vëmendje kësaj çështje gjithnjë e më të rëndësishme. Sidoqoftë, është koha që sistemet dhe traktatet e pronësisë intelektuale kombëtare dhe ndërkombëtare të rivlerësohen në funksion të këtij problemi që prek çdo qenie njerëzore.³

Në bazë të këtij punimit shkencor do të vlersohet se ligjet aktuale pronësinë intelektuale a mund të ndihmojnë në uljen e niveleve te CO₂, dhe mbrojtjen e mjedisit jetësor. Gjithahstu do te vlersohet se a janë të mjaftueshme instrumentet e pronësisë intelektuale me masat mbrojtëse që i ofrojnë për të limituar nivelete e dioksidit të karbonit në atmosferë, si dhe se si këto ligje a mund të përmirësohen edhe më shumë për të paraqitur suksese dhe rezultate më efikase.

¹Estaelle Derclaye, Intellectual Property Rights and Global Warming, 12 Marq. Intellectual Property L. Rev. 263 (2008).

² Charlotte Streck & David Freestone, The EU and Climate Change, in Reflections On 30 Years Of EU Environmental Law, A High Level Of Protection?, 85, 102 (Richard Macrory ed., Europa Law Publishing 2006).

³Abbe EL Brown, Intellectual Property and Climate Change, in Rochelle Dreyfuss and Justine Pila(eds.) The Oxford Handbook of Intellectual Property Law, Oxford University Press, 2018, p. 958.

Kapitulli I - Ndryshimet klimatike

1.1 Baza shkencore: Ngrohja globale si pasojë e efektit të serrës

"Ndryshimi i klimës" ka ardhur të nënkuptojë rritje të temperaturës për shkak të veprimtarisë njerëzore dhe serës së rritur, emetimet e gazit, të cilat kanë një efekt të dëmshëm për mjedisin. Ajo dukshëm ndot ajrin, paraqet sëmundje të rreja dhe pamundëson jetë të shëndoshë. Gazra të caktuar në atmosferën tonë, CO₂, metani dhe avulli i ujit ndihmojnë për ngrohur atmosferën tonë. Këto gazra quhen "gazra serë" dhe ato e ngrohin atmosferën duke e perthirur nxehtësinë dhe duke e rrezatuar përsëri në sipërfaqen e Tokës.

Pa efektin serë Toka do të ishte shumë e ftohtë. Gazrat e serrës ndodhin natyrisht dhe janë thelbësore për mbijetesën e njerëzve dhe gjallesave tjera, mirëpo tani sasi të gazrave serë në atmosferë janë rritur në nivele që nuk janë parë në tre milion vjet.

Para 10,000 Toka ishte me më shumë tokë, gjelbrim dhe ujë, kishim llojlojshmëri të botës së egër. Tash Bota e egër ka rra për 35%. Mënyra se si ne jetojmë, e bën bioviristetin të bjere dhe kjo ndodh si rezultat i planifikimit të keq. Mirëpo, cdo here qëndron një shpresë. Me ndihmen tonë bota mund të shërohet dhe të bëhet përsëri një vend i sigurtë për të jetuar.

Në vitin 1937:

- Popullsia e botës ishte 2.3 BILLION,
- 280 pjesë karboni për million dhe
- 66% nga bota e egër.

Në vitin 1954:

- Popullsia e botës ishte 2.7 BILLION,
- 310 pjesë karboni për million dhe
- 64% nga bota e egër

Pas vitit 1954 filluan të prodhohen risitë si: vetura, aeroplani, kur njerzit mendonin se cdo gjë që kan ëndruar më do ta ken në realitet, mirëpo nuk e dinin se problem do të qëndroj në këto gjëra.

Në vitin 1960:

- Popullsia e botës ishte 3.0 BILLION,
- 315 pjesë karboni për million dhe
- 62% nga bota e egër

Shumë specie të botës së egër janë në zhdukje, si Zebrat, Gazela, Ariu Polar.

Në vitin 1978:

- Popullsia e botës ishte 4.3 BILLION,
- 355 pjesë karboni për million dhe
- 55% nga bota e egër

Në vitin 1980 peshkaqenët po vriteshin në masë të madhe nga flotat e anijeve, andaj në këto vite filluan edhe portesta të mëdhaja. 3 trilion drunjë priten në botë, gati gjysma e pyjeve të botës janë pastruar. Nësë vazhdojmë të bëjmë këto gabime, ne nuk dot kemi ekosistem.

Në vitin 1997:

- Popullsia e botës ishte 5.9 BILLION,
- 360 pjesë karboni për million dhe
- 54% nga bota e egër

Shkenctarët kanë zbuluar se deri në vitet 90% temperature e tokës ka qen stabile. Tanimë pasi bota ka ndryshuar klimën, në Antartik mund të lundrojmë me anije në vende tek të cilat historikisht ka qenë të bllokuara nga akulli. Në oqeanin Arktik akulli është reduktuar 40% në 40 vjet. Uji I pijshëm dhe I freskët është reduktuar për mbi 80%.

Në vitin 2020:

- Popullsia e botës ishte 7.8 BILLION,
- 415 pjesë karboni për million dhe
- 35% nga bota e egër

Pyjet e Amazonës kanë sjellur humbje katastrofike. Pasi akujnajat shkrihen, rezatimi i diellit reflekton direkt në hapsirë.⁴

Aksioni kundër ndryshimit të klimës është përqendruar në zbutjen e këtyre emetimeve (p.sh., duke përdorur më pak lëndë djegëse fosile dhe duke përdorur më pak energji), adaptim (p.sh., zhvillimin e ilaçeve për sëmundje të reja që janë shfaqur si pasojë e ndryshimit të klimës).

⁴David Attenborough, A Life on Our Planet: My Witness Statement and a Vision for the Future, Ebury Publishing, 2020, p. 5.

1.1.1 Përkufizimi i ndryshimit të klimës

Një ndryshim global dhe rajonal i klimës, i dukshëm nga fundi i shekullit 20 i cili i atribuohet kryesisht niveleve të rritura të dioksidit të karbonit atmosferik të prodhuara nga përdorimi i karburanteve fosile përkufizohet si ndryshim i klimës. Ndryshime klimatike janë ndryshime të shkaktuara nga ndikimet antropogjene në sistemin klimatik, në pajtim me Konventën kornizë të Kombeve të Bashkuara për ndryshimet klimatike.⁵

Klima qëndron të jetë moti i zakonshëm i një vendi. Klima mund të ndryshojë me ndryshimin e sezoneve. Nje vend mund të ketë klimë të ngrohtë dhe të thatë gjatë verës, kurse në dimër të jetë i freskët dhe i lagësht. Disa vende mund të jenë me temperatura të ulta gjat gjithë kohës, ndërsa disa të tjera mund të jenë me temperatura të larta ku moti është gjithmonë i ngrohtë për të notuar jashtë. Egziston edhe klima e Tokës. Kombinimi i të gjitha klimave në mbarë botën paraqet klimën e tokës.⁶

Ndryshim i klimës është ndryshim në motin e zakonshëm që gjendet në një vend. Ky ndryshim mund të duket në shi, se sa shi zakonisht merr një vend në vit, apo në ndryshimin e temperaturës së zakonshme të një vendi për një muaj apo sezonë. Ndryshim i klimës mund të jetë një ndryshim në temperaturën e zakonshme të Tokës ose ndryshimi i klimës është një ndryshim afatgjatë i reshjeve, temperaturave ose modeleve të erës që zgjat për disa dekada ose më shumë.

Moti mund të ndryshojnë mbrenda disa orëve, kurse Klima kërkon qindra apo edhe miliona vjet për të ndryshuar. Njerëzit që studiojnë Tokën shohin se klima e Tokës po bëhet më e ngrohtë. Temperatura e Tokës është rritur rreth një shkallë Fahrenheit në 100 vitet e fundit. Kjo paraqet kërcënim të madh drejt prodhimit të ushqimit, drejt ngritjes së niveleve të detit që mund të rrisin rrezikun e përmbajtje katastrofike.

Ndikimi më i madh njerëzor ka qenë emetimi i gazrave të serrës, me mbi 90% të ndikimit nga dioksidi i karbonit dhe metani. Djegia e karburanteve fosile është burimi kryesor i këtyre gazrave; emetimet bujqësore dhe shpyllëzimi janë gjithashtu të rëndësishme. Pra, veprimtaritë e njerëzve shkaktojnë ndryshime klimatike, me shembuj të tjerë: duke drejtuar makina, me ngrohje dhe ftofje të shtëpive të tyre, duke u djegur qymyr, naftë dhe gaz, ku këto gazra e bëjnë që ajri të nxehet.

Shkenctarët parashohin se temperatura e Tokës do të vazhdojë të rritet për 100 vitet e ardhshme. Kjo do të shkaktojë shkrijen e më shumë borës dhe akullit. Oqeanet do të ngriheshin më lart. Disa vende do të nxeheshin. Vende të tjera mund të kenë dimra më të ftohtë dhe më shumë borë. Disa vende mund të kenë më shumë shi. Disa vende mund të kenë uragane më të forta.⁷

⁵Ligj për mjedisin jetësor, tekst i konsoliduar 1, neni 5.

⁶<https://www.nasa.gov/audience/forstudents/k-4/stories/nasa-knows/what-is-climate-change-k4.html>

⁷Dan Stillman/Institute for Global Environmental Strategies/JoCasta Green/NASA Educational Technology Services Aug 7, 2017.

Lidhur me temperaturën në Maqedoninë Veriore, ka një përplasje të ndikimeve të detit nga jugu (në luginat e Vardarit, Strumicës dhe Crn Drim), me përparimet më të ftohta kontinentale nga veriu. Temperatura mesatare vjetore e ajrit në Republikën e Maqedonisë Veriore është 11.5 ° C dhe sillet nga rreth 0 ° C në malet e larta deri në 15 ° C në zonat jugore përreth Dojran dhe Valandovo. Muaji më i ngrohtë është korriku me një temperaturë mesatare prej 22.2 ° C, dhe muaji më i ftohtë është janari me një mesatare prej 0.3 ° C. Deri më tani, temperatura më e ulët e matur e ajrit është -32 ° C në Berovë, dhe më e larta 48 ° C në Demir Kapija.⁸

Egzistojnë dëshmi alarmante, andaj, njerzit duhet të ndihmojnë që të parandalohet kjo dukuri, duke qenë më të kujdesshem, duke përdorur më pak ujë dhe energji, duke mbjellë pemë dhe duke marr më shumë njohuri rreth Tokës që të ndihmoni në zgjedhjen e kësaj problematike.

1.1.2 Mekanizmi i efektit të serrë

Me rritjen e vazhdueshme të ngrohjes globale, bashkë me të edhe ideja e efektit të serrës vazhdon të diskutohet gjithnjë më shumë. Pjesa më e madhe e energjië diellore (45%) rrezatohet përsëri në hapësirë. Gazrat serë në atmosferë kontribuojnë në ngrohjen globale nga thithja dhe reflektimi i energjisë atmosferike dhe diellore. Ky fenomen natyror është ai që ne e quajmë efekti serë. Nëse gazrat sere nuk dot egzistoni, temperature e tokës do të ishte nën 18°C.⁹

Gazrat serrë janë shumë të rrëndësishem për jetesë të qëndrueshme, mirëpo egzistojnë edhe pasojat e rrënda të tyre, nëse kemi nivel të lartë të Gazrave Serrë. Nga kjo që u tha kuptojmë se gazrat serrë kanë ndikim pozitiv dhe negativ në mjedisin ton.

Gazrat kryesorë të serrës përfshijnë Dioksid karboni, Metan, Oksid Azoti dhe Ozon. Këto gazra nuk mund të parandalojnë rrezatimin diellor që hyn në sipërfaqen e Tokës, andaj shkaktohet rritja e temperatures. Efekti serrë ka egzistuar gjithmonë, mirëpo tani po përballemi me probleme për shkak të rritjes së CO₂. Me rritjen e CO₂, po rritet edhe fuqia për të bllokuar rrezatimin diellor dhe për ta drejtuar atë në sipërfaqen e tokës. Prandaj themi se efekti serrë është shkak i problemit. Në fakt, është ndërhyrja njerëzore që ka prishur ekuilibrin midis rrezatimit hyrës dhe dalës, për shkak të rritjes së CO₂ që është problematike.¹⁰

Në fillim të kapitullit cekëm se, efekti serrë është shumë i rëndësishëm për jetesë të qëndrueshme, dhe nga ai kemi disa përfitime, edhe atë:

1. Efekti sere mbështet dhe promovon jetë

⁸ Квалитет на животната средина во Република Северна Македонија, Годишен извештај воздух 2019 стр. 11.

⁹ S.M. Enzler, The greenhouse effect mechanism: <https://www.lenntech.com/greenhouse-effect/greenhouse-effect-mechanism.htm>

¹⁰ <https://medium.com/@tutorbin/greenhouse-effect-advantages-and-disadvantages-4d4f113ec61d>

- Që të mund të jetojmë, temperature e tokës duhet të jetë normale. Këtë normale e mbajnë gazrat serë, të cilët nuk lejojnë që toka të ngri nga temperaturat e ulta ose të shkrihet dhe të digjet nga rrezatimi diellor. Ato po ashtu janë të rëndësishme për të ruajtur nivelin e ujit në tokë.

2. Mbrojtja nga rreziku

- Gazrat serë na mbrojnë nga rrezet e diellit të ashtuquajtura UV apo Ultra Violet të cilat janë shumë të dëmshme për egzistencën tone dhe sipërfaqen e tokës. Këtë lloj mbrojtje e kryen Ozoni, i cili vepron si mburojë kunder rrezeve UV që hyn në atmosferen e tokës.

3. Përfitimet e gazrave serë për fotosintezën

- Fotosinteza, procesi me të cilin bimët krijojnë ushqimin e tyre dhe nga ana tjetër fillojnë zinxhirin ushqimor për ekzistencë varet nga tre elementë të rëndësishëm. Këto përfshijnë CO₂, ujë dhe rrezet e diellit. CO₂ i cili është një gaz i rëndësishëm serrë është jetësor këtu. Në mungesë të këtij gazi, bimët nuk do të jenë në gjendje të prodhojnë ushqim. Meqenëse efekti serë kontribuon në rritjen e niveleve të CO₂, nën kushte të kontrolluara, mund të çojë në prodhim më të madh të ushqimit.¹¹

Argumentuam se efekti i serrës kishte rolin që ta mbajë temperature e tokës në normale për të genë toka e banueshme. Mirëpo ajo i mban edhe dizavantazhet e veta, të cilat do ti cekim në vazhdim:

1. Ngrohja globale

- Djegja e lëndëve fosile, kontribon në rritjen e temperatures mesatarë të tokës. Meqenëse gazrat rriten, aftësia dhe fuqia e tyre për të kapur nxehtësinë dhe për ta rrezatuar përsëri në tokë gjithashtu rritet;

2. Rritja e niveleve të ujit

- Me ngrohje të temperaturave, pësojmë shkrije të akullnajve. Kjo rezulton në rritje massive të niveleve të ujit, e cila mund të çojë deri në përmbytje të zonave të ulta. Egzistenca e pinguinëve dhe ariut polar është nën kërcënim të thellë;

3. Shkatërrimi i jetës detare

- Oqeanet thithin CO₂ dhe mbajnë alkanitetitn. Meqenëse CO₂ rritet në shkallë të madhe, kjo paraqet kërcënim për jetën detare, nëse vazhdon rritja a alkalinitetit;

4. Avullimi i furnizimeve me ujë, duke shkaktuar mungesë të ujit të pijshëm;

¹¹<https://medium.com/@tutorbin/greenhouse-effect-advantages-and-disadvantages-4d4f113ec61d>

5. Depërtimi i ujërave të kripura në zonat e ujërave nëntokësore;
6. Mot më ekstrem, duke shkaktuar verë më të nxehtë dhe të thatë dhe dimër më të ftohtë;
7. Sëmundje më ngjitëse sepse ambienti është më pozitiv për patogjenët dhe disa insekte të rrezikshëm, siç është mushkonja e malaries;
8. Shkrirja e akullit polar dhe zgjerimi oqeanik
 - Kjo rezulton në përmytjen e zonave bregdetare, kënetave, ligatinave dhe deltave të lumenjve;
9. Rritja e numrit dhe ashpërsisë së stuhive tropikale dhe cikloneve.¹²

Duke parë emetimet e drejtpërdrejta të gazrave serrë ne RMV, emetimet e CO₂ përbëjnë 75-80% të emisioneve totale për periudhën e mbuluar (kryesisht nga djegia e karburantit në sektor. Emetimet e CH₄ përbëjnë 12–14% (kryesisht nga bujqësia dhe mbeturinat), emetimet e N₂O përbëjnë 7–9% të emisioneve totale (nga djegia e karburantit dhe emetimet e tokës) dhe 1-2% janë emisione të HFC nga sektori i industrisë. Për gazrat indirekte të serrave, shumica e emetimeve të NO_x (7% të emisioneve totale indirekte të gazrave serrë në periudhën e mbuluar) dhe emetimet e CO (32%) janë nga sektori i energjisë, transporti dhe industria e energjisë (qymyr, linjiti), nga djegia në bujqësi (mbetjet e të korrave) dhe nga sektori i përdorimit të tokës, ndryshimet në përdorimin e tokës dhe pyjeve (zjarret ne pyje). Emetimet e NMVOC (25%) vijnë nga industria, veçanërisht proceset e prodhimit, dhe një pjesë e vogël e sektorit të transportit dhe përdorimi i tretësve, ndërsa shumica e emetimeve të SO₂ (36%) vijnë nga energjia, ndërtimi dhe transporti.¹³

Mbledhja dhe përpunimi i të dhënave për emetimet e ajrit kryhet vazhdimisht gjatë gjithë vitit në kuadër të punës së sektorit Qendra Informativ e Mjedisit të Maqedonisë.¹⁴

1.1.3 Efektet e rrezatimit diellor

Jeta në Tokë nuk mund të egzistojë pa rrezatimin jetëdhënës të diellit. Ekspozimi ndaj rrezeve të diellit siguron përfitime shëndetësore, mirëpo nuk mund të thuhet se kjo nuk i ka edhe efektet e saj anësore, andaj ekspozimi i tepërt mund të coje në problem shëndetësore të rrezikshme për jetën. Vitamina D është vitaminë që merret nëpërmjet diellit, mirëpo njerëzit të cilët nuk kanë kohë të qëndrojnë në natyrë, këtë vitamin mundën ta marrin me tableta ose ushqime të fortifikuara për të marrë dozen e nevojshme.

¹²<https://www.lenntech.com/greenhouse-effect/greenhouse-effect-mechanism.htm>

¹³ COEP-MK: https://www.moep.gov.mk/?page_id=5170&lang=en

¹⁴ Квалитет на животната средина во Република Северна Македонија ГОДИШЕН ИЗВЕШТАЈ ВОЗДУХ 2019

Ana anësore qëndron në rrezet ultra vjollcë UV, të cilat paraqiten të dëmshme për njerëzit dhe mjedisin. Rrezet ultra vjollcë mund të shkaktojnë dëmtime të lekurës, andaj ekspozimi afatgjatë ndaj UVA dhe UVB dëmton lekurën e njeriut dhe kjo mund të çojë deri në kancer të lëkurës. Rrezatimi diellor poashtu rezulton dëmshëm në sytë e njeriut. Organizata Botërore e Shëndetësisë vlerëson se 20% e të ataraktave rrjedhin ose përkeqësohen nga ekspozimi i tepërt i diellit, dhe rrezatimi ultraviolet mund të rrisë shanset për sëmundje të tjera të syve. Sipas Shoqërisë së Fizikës së Shëndetit, rrezatimet kanë një efekt pozitiv në rritjen e bimëve në nivele më të ulta rrezatimi dhe efekte të dëmshme në nivele të larta. Ekspozimi i zgjatur i rrezatimit mund të shkaktojë plotësisht pjellorinë e bimës dhe bima gradualisht vdes. Rrethinat gjithashtu bëhen helmuese dhe mund të parandalojnë rritjen e pasardhësve të ardhshëm.¹⁵

1.1.4 Ndikimet e njeriut në ndryshimin e klimës

Me faktin se gazrat serë kanë ekzistuar gjithmonë në atmosferë, me qëllim që të mbajnë temperaturën e tokës në një mesatare, kuptohet që kjo problematikë e gazrave sere ka ardhur më vonë, edhe atë nga veprimtaritë njerëzore, të cilët kanë kontribuar në rritjen e nivelit të CO₂ në atmosferë. Potenciali për aktivitetet njerëzore për të rritur temperaturën e Tokës përmes emetimeve të gazrave serë është përshkruar dhe llogaritur për më shumë se një shekull. Vëllimet e kërkimit shkencor nëpër disiplina të shumta shkencore bien dakord që njerëzit po ngrohin klimën dhe Raporti i katërt i Vlerësimit IPCC 2013, "Ndikimi i njeriut në sistemin e klimës është i qartë. Kjo është e dukshme nga rritja e përqendrimeve të gazeve serë në atmosferë".¹⁶

Egzistojnë prova mbizotëruese, se aktivitetet njerëzore, duke djegur lëndë fosile, duke prodhuar bagëti, po rrisin temperaturën e tokës dhe oqeanëve dhe paraqiten si shkak kryesor i ndryshimeve klimatike.

Hulumtimi bie në disa linja provash të studiuara në mënyrë të pavarur, por të lidhura fizikisht:

- Kimi e thjeshtë - Kur djegim materiale me bazë karboni, emetohet dioksid karboni (CO₂) (kërkimi fillon në vitet 1900).
- Analiza Kimike e CO₂ - zbulon se rritja e CO₂ vjen nga djegia e lëndëve fosile (kërkimi fillon në vitet 1950)
- Fizika themelore - që na tregon se CO₂ thith nxehtësinë (kërkimi fillon në vitet 1820).
- Përjashtimi i faktorëve natyrorë që mund të ndikojnë në klimën si dielli dhe ciklet oqeanike (kërkimi fillon në vitet 1830).

¹⁵Disha Kashyap, Effects of Radiation on Plants and Animals: <https://www.yourarticlelibrary.com/radiations/effects/effects-of-radiation-on-plants-and-animals/63634>

¹⁶Human activities are impacting the climate system. https://cleanet.org/clean/literacy/principle_6.html

- Rritja e gazrave serrë – në nivele më të larta se cdo gjë që kemi parë në gati një million vjet (matjet fillojnë në vitet 1950) ¹⁷

Paneli Ndërqeveritar për Ndryshimin e Klimës, një grup prej 1,300 ekspertësh të pavarur shkencorë nga vendet e të gjithë botës nën kujdesin e Kombeve të Bashkuara, arriti në përfundimin se ka një probabilitet më shumë se 95 përqind që aktivitetet njerëzore gjatë 50 viteve të fundit kanë ngrohur planetin tonë.¹⁸

Aktivitetet industriale nga të cilat varet civilizimi ynë modern kanë rritur nivelet e dioksidit të karbonit atmosferik nga 280 pjesë për milion në 414 pjesë për milion në 150 vitet e fundit. Këtë trend global nuk mund të thuhet se e ka shkaktuar Dielli. Disa prova argumentojnë se Dielli nuk mund të shkaktojë këtë ngrohje globale:

- Që nga viti 1750, sasia mesatare e energjisë që vjen nga Dielli ose mbeti konstante ose u rrit pak;
- Nëse ngrohja do të shkaktohej nga një Diell më aktiv, atëherë shkencëtarët do të prisnin të shihnin temperatura më të ngrohta në të gjitha shtresat e atmosferës. Në vend të kësaj, ata kanë vërejtur një ftohje në atmosferën e sipërme dhe një ngrohje në sipërfaqe dhe në pjesët e poshtme të atmosferës. Kjo sepse gazrat serrë po bllokohen në atmosferën e ulët. Gazrat serrë paraqiten problem të cilët e bllokohen në xehësinë infra të kuqe.¹⁹

Në vazhdim do të përmendi disa fakte që të bëjnë të shohim se gjendja është shumë alarmante:

416 pjesë për milion

Përqendrimi i dioksidit të karbonit (CO₂) në atmosferën tonë, që nga maji i vitit 2020, është më i larti që ka qenë ndonjëherë në historinë njerëzore.²⁰

2019 ishte viti i dytë më i ngrohtë i regjistruar

Të dhënat e NASA tregojnë se temperaturat mesatare globale në 2019 ishin 1.8 gradë F (0.98 gradë C) më të ngrohta se mesatarja e shekullit të 20-të.²¹ Në fakt, pesë vitet më të ngrohta në rekordin 1880–2019 kanë ndodhur të gjitha që nga viti 2015.²²

¹⁷ Environmental defense fund: <https://www.edf.org/climate/why-fighting-climate-change-so-urgent>

¹⁸ <https://climate.nasa.gov/causes/>

¹⁹ Global Climate Change Vital Signs of the Planet / The Causes Of Climate Change / [Causes | Facts – Climate Change: Vital Signs of the Planet \(nasa.gov\)](#)

²⁰ Willeit, M., Ganopolski, A., Calov, R., & Brovkin, V. (2019). *Mid-Pleistocene transition in glacial cycles explained by declining CO₂ and regolith removal*. Science Advances, 5(4), eaav7337. <https://doi.org/10.1126/sciadv.aav7337>

11% e emetimeve

Njëmbëdhjetë përqind e të gjitha emisioneve globale të gazrave serë të shkaktuara nga njerëzit janë për shkak të shpyllëzimeve.²³

800 milion njerëz

Njëmbëdhjetë përqind e popullsisë së botës aktualisht është e prekshme nga ndikimi i ndryshimeve klimatike, të tilla si thatësira, përmbytje, valë të nxehtësisë, ngjarje ekstreme të motit dhe ngritje të nivelit të detit.²⁴

Çmimi: 140 miliardë dollarë në vit

Kjo është ajo që do të duhet për të bërë ndryshimet që i duhen njerëzimit për t'u përshtatur në një botë që po vazhdon të ngrohet. Mund të tingëllojë si shumë, por është më pak se 0.2% e PBB-së globale.²⁵ Dhe kostoja do të rritet në vlerë më të madhe nëse vazhdojmë pa marrë masa.

1.1.5 Pasojat e ndryshimit të klimës

Ngrohja globale prek gjithë rajonet në mbarë botën. Akullnajat po shkrihen dhe kemi rritje të nivelit të detit. Ngjarjet ekstreme të motit, rreshjet e shiut, vullkane, nxehtësi dhe thatësira po bëhen të zakonshme në shume rajone. Këto dukuri pritet të intensifikohen në dekadat e ardhshme. Me ngrohjen e temperaturave, pësojmë shkrije të akullnajave polare dhe si pasojë kemi rritje në nivelet e detit, e cila rezulton përmbytje dhe erosion të zonave bregdetare dhe të ulëta. Akulli po shkrihet në të gjithë botën, veçanërisht në polet e Tokës. Kjo përfshin akullnajat malore, shtresat e akullit që mbulojnë Antarktidën Perëndimore dhe Grenlandën dhe akullin e detit Arktik. Në Parkun Kombëtar të Akullnajave të Montanës, numri i akullnajave ka rënë në më pak se 30 nga më shumë se 150 në 1910. Pjesa më e madhe e këtij akulli që shkrihet kontribuon në ngritjen e nivelit të detit. Nivelet globale të detit po rriten 0.13 inç (3.2 milimetra) në vit, dhe ngritja po ndodh me një ritëm më të shpejtë në vitet e fundit.²⁶

Rreshjet ekstreme të shiut mund të rezultojnë në përmbytje dhe ulje të cilësisë së ujit. Në Evropë shihen valet më të shpeshta të nxehtësisë, zjarre në pyje dhe thatësira. Zona e Mesdheut po ashtu

²¹ NASA. (2020, January 15). *NASA, NOAA Analyses Reveal 2019 Second Warmest Year on Record*. <https://www.nasa.gov/press-release/nasa-noaa-analyses-reveal-2019-second-warmest-year-on-record>. Accessed: 2020-06-09.

²² NOAA. *Global Climate Report - 2019*. <https://www.ncdc.noaa.gov/sotc/global/201913>. Accessed: 2020-06-09.

²³ Goodman, R.C., Herold, M. (2014). *Why Maintaining Tropical Forests Is Essential and Urgent for a Stable Climate - Working Paper 385*. Center for Global Development. <https://www.cgdev.org/publication/why-maintaining-tropical-forests-essential-and-urgent-stable-climate-working-paper-385>

²⁴ DARA. (2012). *Climate Vulnerability Report - 2nd Edition*. <https://daraint.org/wp-content/uploads/2012/09/CVM2ndEd-FrontMatter.pdf>.

²⁵ Worldometer. *Global GDP this year*. <https://www.worldometers.info/gdp/>. Accessed: 2020-06-09.

²⁶ NationalGeographic/environment/global-warming-effects

bëhet ende më e thatë. Evropa Veriore po lagështohet dhe priten përmbytje në sezonën e dimrit. Evropa nuk është e pajisur për të ju përshat ndryshimeve klimatike. Ndryshimet klimatike po ashtu kanë ndikim në paraqitjen e sëmundjeve të reja. të patogjenëve, infektuese dhe vdekjepruese. Ka pasur një rritje në numrin e të vdekurve në disa rajone shumë të nxehta. Kushtet e ngrohta të dimrit në New York në vitin 1999, kanë lehtësuar shpërthimin e virusit të Nilit Perëndimor, si dhe në New Orleans gjatë fillimit të viteve 1990 shpërthyen mushkonja dhe buburreca që mbanin sëmundje. Dimrat e ngrohtë në gadishullin e Koresë dhe në Evropën Jugore kanë lejuar përhapjen e mushkonjës Anopheles, e cila mbart parazitin e malaries, ndërsa në Skandiva dimrate e ngrohtë në vitet e fundit kanë lejuar përhapjen e sëmundjes së encefalitit.²⁷

Dëmtimi i pronës dhe infrastrukturës dhe shëndetit të njeriut imponon kosto të mëdha në shoqëri dhe ekonomi. Midis 1980 dhe 2011 përmbytjet preken më shumë se 5.5 milion njerëz dhe shkaktuan humbje të drejtpërdrejta ekonomike prej më shumë se 90 miliardë €. ²⁸ Bujqësia, pylltaria, energjia dhe turizmi janë veçanërisht të prekur. Në qoftëse kemi rritje të pakontrolluar të temperaturës, nëse temperaturat mesatare të sipërfaqes globale rriten edhe 1.5 deri 2.5 °C, kjo do të rezultojë në zhdukjen e disa specieve biomore dhe shtazore. Ekologë të shumtë, biologë dhe shkenctarë tjerë parashohin se 16% e specieve të Tokës do të zhduken nëse ngrohja sipëraqësore rritet rreth 4.3 °C.²⁹

Ndryshimet Klimatike kanë prekur edhe lumenjtë dhe kanë dëmtuar peshqit e lumenjve. Pasoja të tjera të mundshme në mjedis përfshijnë shkatërrimin e shumë ligatinave bregdetare, kënetave të kripës dhe kënetave të mangrove, acidizmi i oqeanit për shkak rritjes së përqendrimeve të HCO₃ në ujë si pasojë e rritjes së përqendrimeve të CO₂.

Nëse temperaturat vazhdojnë të rriten në këtë vale, pasojat do të jenë më të rëndë. Nivelet e detit pritet të rriten midis 10 dhe 32 inç (26 dhe 82 centimetra) ose më të larta deri në fund të shekullit. Uraganet dhe stuhitë e tjera ka të ngjarë të bëhen më të forta. Përmbytjet dhe thatësira do të bëhen më të zakonshme. Më pak ujë të ëmbël do të jetë në dispozicion, pasi akullnajat ruajnë rreth tre të katërtat e ujit të ëmbël në botë. Disa sëmundje do të përhapen, të tilla si malarja e lindur nga mushkonjat (dhe ringjallja e vitit 2016 e virusit Zika). Ekosistemet do të vazhdojnë të ndryshojnë: Disa specie do të lëvizin më larg në veri ose do të bëhen më të suksesshme; të tjerët, të tilla si ariu polar, nuk do të jenë në gjendje të përshtaten dhe mund të zhduken.³⁰

1.1.6 Përpyjekjet për ambient të pastër dhe përpyjekjet për të ulur ngrohjen globale duke zvogëluar emetimet e gazrave serra në RMV dhe në vendet tjera të botës

²⁷ Britanica.com/Science/global-warming/Environmental-consequences-of-global-warming/

²⁸ [European Commission > Energy, Climate change, Environment > Climate Action > Climate Change](http://European-Commission.com/Energy,Climate-change,Environment/Climate-Action/Climate-Change)

²⁹ Britanica.com/Science/global-warming/Environmental-consequences-of-global-warming/

³⁰ [National Geographic/environment/global-warming-effects/](http://National-Geographic.com/environment/global-warming-effects/)

Duke marrë veprime për të zvogëluar emetimet e ndotjes së gazit serrë që po shkakton ngrohje globale, duke punuar së bashku në rregullimin legjislativ për mjedisin jetësor, duke drejtuar më pakë automjete, duke ruajtur energjinë elektrike dhe duke krijuar më pakë mbeturina ne mund të zvogëlojmë rreziqet që do ti hasim në të ardhme nga ndryshimi i klimës. Në vijim kemi rregullimin e legjislacionit të RMV në fushën për parandalim të rritjes së ndotjes së ajrit, mënyrat e mbrojtjes së ambientit dhe masat e ndërmara për të pasur një ambient të pastër.

Në Republikën e Maqedonisë së Veriut qytetarët e saj i kanë të ndaluara veprimet vijuese:

- ndërtimi ose rikonstruktimi i instalimeve, pa marrjen e lejes dhe me këtë rast pa u plotësuar normat dhe standardet e përcaktuara të sistemit për mbrojtjen dhe përparimin e mjedisit jetësor;
- prodhimi dhe importi i mjeteve transportuese, të cilat nuk i plotësojnë kushtet e përshkruara për emisione te burimet mobile të ndotjes dhe të zhurmës;
- prodhimi, veprimi dhe lëshimi i materieve dhe substancave ndotëse në mjedisin jetësor, përveç në mënyrën dhe në kushtet e përshkruara me ligj.³¹

Personi juridik respektivisht tregtari individ që kryen import ose eksport të substancave që e varfërojnë mbështjellësin e ozonit dhe të prodhimeve që përmbajnë substanca të tilla, duhet të posedojë leje, të cilën e lëshon organi i administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e mjedisit jetësor.³²

Me mjetet për ftohje ose me produkte që përmbajnë mjete për ftohje duhet të veprohet në mënyrë me të cilën pengohet lirimi i substancave të rrezikshme të dëmshme për mjedisin jetësor dhe sigurohet mirëmbajtja e tyre e rregullt dhe pengimi i rrjedhjeve.³³

Çdo teknologji e vendit ose e importuar, vijë teknologjike, prodhim, gjysmëprodukt ose lëndë e parë, e cila nuk i plotëson normat e përshkruara për mbrojtjen e mjedisit jetësor, nuk mund të shfrytëzohet në territorin e Republikës së Maqedonisë.³⁴

Ministri i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për punët nga lëmi i mjedisit jetësor, si dhe kryetari i Qytetit të Shkupit dhe kryetari i komunës në qytetin e Shkupit

³¹Ligji për mjedisin jetësor, neni 20 Dispozita e përgjithshme lidhur me kryerjen e aktiviteteve / fq. 11.

³²Ligji për mjedisin jetësor tekst i konsoliduar, neni 22-a Veprimi me substanca të cilat e varfërojnë mbështjellësin e ozonit.

³³ LIGJ PËR MJEDISIN JETËSOR TEKST I KONSOLIDUAR OBLIGIMET E PËRGJITHSHMENeni 22-b Licenca për veprim me mjete për ftohje dhe/ose produkte që përmbajnë mjete për ftohje

³⁴ LIGJ PËR MJEDISIN JETËSOR TEKST I KONSOLIDUAR OBLIGIMET E PËRGJITHSHME Neni 23 Ndalimi i zbatimit të teknologjive, vijave teknologjike, prodhimeve, gjysmëprodukteve dhe lëndëve të para

janë të obliguar të informojnë opinionin për raste e tejkalimit të emisioneve të lejueshme edhe në raste tjera të ndotjes së ambientit jetësor nga përmasa më të mëdha.³⁵

Çdo person juridik dhe fizik i cili zbaton projekt, përkatësisht aktivitete, është i obliguar të ndërmarrë masa dhe aktivitete për mbrojtjen dhe përparimin e mjedisit jetësor dhe kthimin e mjedisit jetësor në gjendje të volitshme.³⁶

Egziston organ i administrates shtetërore Kadastri për mjedisin jetësor i cili përmban të dhëna për aktivitetet të cilat mund ta rrezikojnë mjedisin jetësor.³⁷

Organet dhe organizatat e ndryshme, grupe operatorësh ose operatorë të vecantë, mund të lidhin marrëveshje vullnetare me organin e administrates shtetërore me qëllim që në medium të caktuara të mjedisit jetësor të arrihet një shkallë më e lartë e mbrojtjes.³⁸

Për përparim të mjedisit jetësor në RMV bëhen hulumtime shkencore dhe teknologjike, shpallen rrezultate nga hulumtimet e tyre si dhe aftësimi i rezultateve nga hulumtimet.

Për mbrojtjen e ambientin jetësor, plani drejtohet në zhvillimin ekonomik, shoqëror dhe kulturor të RMV, si dhe harmonizimi i masave dhe aktiviteteve ekonomike, teknike si dhe masave përzbatimin e obligimeve të ndërmarra me ratifikimin e marrëveshjeve ndërkombëtare të ratifikuara, me qëllim që të të sigurohet zhvillim i qëndrueshëm.

Në RMV poashtu egziston ligj për përgjegjësin për dëmin ekologjik I bazuar në parimin “ndotësi paguan”. Përgjegjësi për dëmin ekologjik ka personi I cili ka kryer dëmin drejtëpërdrejt si pasojë e kryerjes së aktiviteteve profesionale.

Për shkak të menaxhimit me të dhënat për emisionet antropogjene të gazrave serrë sipas burimeve dhe humbjeve në atmosferën e territorit të Republikës së Maqedonisë, organi i administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e mjedisit jetësor vendos, zhvillon, mban dhe koordinon Sistem nacional për inventarizimin e emisioneve të gazrave serrë.³⁹

Qeveria e Republikës së Maqedonisë, me propozim të organit të administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga fusha e mjedisit jetësor, miraton Plan aksionar për parandalimin e shkaqeve dhe zbutjen e efekteve negative të ndryshimeve klimatike.

Plani aksionar për ndryshimet klimatike përmban:

³⁵35 LIGJ PËR MJEDISIN JETËSOR TEKST I KONSOLIDUARIV OBLIGIMET DHE MASAT E VEÇANTA Neni 26 Informimi i opinionit për ndotjen e mjedisit jetësor dhe ndërmarrjen dhe zbatimin e masave të obligueshme

³⁶36 LIGJ PËR MJEDISIN JETËSOR TËKST I KONSOLIDUAR Neni 28 Obligimi për mbrojtjen e mjedisit jetësor dhe rajonin ekologjikisht të pastër

³⁷37 XIX ZHVILLIM I QËNDRUESHËM DHE PYETJE TË PËRGJITHSHME NGA FUSHA E MJEDISIT JETËSOR SISTEMI NACIONAL INFORMATIV PËR MJEDISIN JETËSOR Neni 42 Kadastri për mjedisin jetësor fq. 97

³⁸38 LIGJ PËR MJEDISIN JETËSOR Neni 30 Marrëveshja vullnetare.

³⁹39 Neni 188-a Sistemi nacional për inventarizimin e emisioneve të gazrave serrë

- masa institucionale dhe juridike,
- masa dhe aktivitete parandaluese për pakësimin e emisioneve të gazrave të qelqta,
- masa dhe aktivitete për zbutjen e efekteve negative nga ndryshimet klimatike,
- masa për edukimin dhe ngritjen e vetëdijes publike,
- masa për aftësimin profesional të kuadrove shkencore, teknike dhe drejtuese;
- kuadër kohor dhe plan financiar për realizimin e masave dhe aktiviteteve të parashikuara.⁴⁰

Programi i 7-të i veprimit mjedisor në Evropë është një dokument kryesor që përshkruan drejtimet afatgjata të politikave në Evropë, politika që përmbajnë një vizion dhe perspektivë për bashkimin deri në vitin 2050. Kjo kornizë politike dhe ligjore është e rëndësishme për Republikën e Maqedonisë Veriore dhe angazhimin e saj për anëtarësim në union.⁴¹Nëse Republika e Maqedonisë hyn në BE deri në vitin 2020, ai do të duhet të zbatojë politikat e BE-së për të zbutur ndryshimin e klimës dhe të jetë pjesë e përpjekjeve të BE-së për ndarjen e emisioneve si pjesë e një skeme të reduktimit të emetimeve prej 20% deri në vitin 2020.

Një plan tjetër për zbutjen e ndryshimit të klimës qëndron tek bujqësia, duke rritur bujqësinë organike. Këtë mund ta realizojmë nëpërmjet menaxhimit më të mirë të mbetjeve nga drithërat, ujitja e spërkatur, menaxhimi më i mirë i plehrave dhe i plehrave natyrorë dhe prodhimi i biogazit në fermat bujqësore. Si anëtare e Komunitetit të Energjisë, Republika e Maqedonisë tashmë ka një detyrim të harmonizojë legjislacionin e saj me *acquis communautaire* të BE-së në lidhje me energjinë, që do të thotë për shembull përdorimi i energjisë së rinovueshme, përfshirja e kriterit për efikasitetin e energjisë në prokurimin publik dhe zvogëlimin e ndotësve të caktuar (p.sh. SOx dhe NOx) nga termocentralet.⁴²

Maqedonia, përmes Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, për më shumë se dhjetë vjet vepron në disa nivele:

- Zhvillon kornizën e nevojshme ligjore për të luftuar ndryshimin e klimës
- Përcakton kornizën e nevojshme strategjike dhe planifikuese
- Bashkëpunon në nivelin dypalësh, rajonal dhe ndërkombëtar në përpjekjet e përbashkëta për të luftuar ndryshimin e klimës.⁴³

Agjencia e mbrojtjes së mjedisit të Shteteve të Bashkuara, bizneset dhe individët gjithashtu kanë role kryesore në problematiken aktuale. Para Samitit të Klimës së Kombeve të Bashkuara 2019 në New York City më 23 shtator, një grup ndërkombëtar ekspertësh, përfshirë shkencëtarin e sistemit Stanford Earth Rob Jackson, ka publikuar një udhërrëfyes e zgjidhjeve më të vlefshme për uljen e emetimeve të gazeve serë globalisht deri në vitin 2030. 36 zgjidhje duke filluar nga

⁴⁰XIX ZHVILLIM I QËNDRUESHËM DHE PYETJE TË PËRGJITHSHME NGA FUSHA E MJEDISIT JETËSOR SISTEMI NACIONAL INFORMATIV PËR MJEDISIN JETËSOR Neni 189 Plani aksion i masave dhe aktiviteteve për parandalimin e shkaqeve dhe zbutjen e efekteve negative të ndryshimeve klimatike

⁴¹ Квалитет на животната средина во Република Северна Македонија ГОДИШЕН ИЗВЕШТАЈ ВОЗДУХ 2019

⁴² СОР-МК-за-воб.

⁴³ КЛИМАТСКИ ПРОМЕНИ И ЗАШТИТА НА ОЗОНСКАТА ОБВИВКА strana 23

dielli, era, biçikletat elektrike, transporti tregtar, shkurimi i emetimeve nga qymyri dhe makinat dhe konsumi i reduktuar i mishit të kuq – këto kanë potencialin të shkallëzohen shpejt.⁴⁴

Teknologjitë diellore, të erës dhe baterive me kosto të ulët janë në trajektore fitimprurëse, eksponenciale që nëse qëndrojnë, do të jenë të mjaftueshme për të përgjysmuar emetimet nga prodhimi i energjisë elektrike deri në 2030. Rritja e automjeteve elektrike ka potencialin të arrijë një pjesë tregu prej 90% deri në vitin 2030 nëse qëndron, por vetëm nëse politikat e forta mbështesin këtë drejtim. Manuel Pugal-Vidal, udhëheqës i klimës dhe praktikës energjetike në WWF, një partner i raportit tha, "Qeveritë duhet të prezantojnë objektivat kombëtarë për të arritur emetimet zero-zero deri në 2050 me synimet për të ulur emetimet 50% deri në 2030. Heqja e menjëhershme e fosileve - subvencionet e karburanteve janë një përparësi. Megjithatë politikat duhet të jenë të drejta dhe fer ose të rrezikojnë dështimin."⁴⁵

Vende të tilla si Britania e Madhe, Franca, Norvegjia dhe Suedia janë duke miratuar ligje për të arritur emetimet zero-zero deri në vitin 2050 ose më herët. Autorët vlerësojnë se zgjidhjet e bazuara në natyrë mund të përdoren për të sekuestruar rreth 9 miliardë ton CO2 në vit deri në vitin 2030. Konventa Ndërkombëtare për Mbrojtjen e Bimëve gjithashtu ka konkluduar me siguri 95 për qind e më shumë nga ngrohja e përshpejtuar e 50-60 viteve të fundit është për shkak të kontributeve njerëzore. Përqindje të mëdha të kësaj rritje janë për shkak të aktiviteteve nga bizneset, fabrikat dhe objektet e tjera tregtare.⁴⁶

Emetimet e dioksidit të karbonit mund të shkaktohen nga energjia e përdorur në fabrika dhe pajisje të tjera për të drejtuar makineri, për të përpunuar lëndët e para, për të ekzekutuar kompjuterë, për tu lidhur me internetin, për ngrohje ftohje të ndërtesave etj. Emetimet e drejtpërdrejta gjithashtu mund të shkaktohen nga rrjedhjet në procesin industrial, reagimet kimike gjatë procesit të prodhimit dhe përdorimi i naftës në prodhim. Emetimet indirekte shkaktohen nga prodhimi i energjisë jashtë vendit, siç janë emetimet e krijuara nga termocentralet nga të cilat objektet marrin energjinë elektrike.⁴⁷

Emetimet nga sektori i industrisë janë kontribues të rëndësishëm në rritjen e niveleve të CO2 dhe gazrave të tjerë serë. Sidoqoftë, ka shumë mënyra se si bizneset dhe fabrikat mund të fillojnë të ulin emetimet e tyre. Disa janë domethënëse, që kërkojnë ndryshimin e standardeve në prodhimin dhe menaxhimin e objekteve. Të tjerat janë të thjeshtë. Vendosija e termostatit vetëm dy gradë më e ulët në dimër dhe dy gradë më e lartë në verë, për shembull, mund të kursejë mijëra paund të emisioneve të dioksidit të karbonit çdo vit për çdo objekt.⁴⁸

⁴⁴ [Stanford.edu/news/roadmap-reducing-greenhouse-gas-emissions-50-percent-2030](https://stanford.edu/news/roadmap-reducing-greenhouse-gas-emissions-50-percent-2030)

⁴⁵ [Stanford.edu/news/roadmap-reducing-greenhouse-gas-emissions-50-percent-2030](https://stanford.edu/news/roadmap-reducing-greenhouse-gas-emissions-50-percent-2030)

⁴⁶ [Woods.stanford.edu/news/roadmap-reducing-greenhouse-gas-emissions-50-percent-2030](https://woods.stanford.edu/news/roadmap-reducing-greenhouse-gas-emissions-50-percent-2030)

⁴⁷ [Thebalancesmb.com/reducing-co2-emissions-315779](https://thebalancesmb.com/reducing-co2-emissions-315779)

⁴⁸ Oak Ridge National Laboratory. "Energy, Carbon-emission and Financial Savings From Thermostat Control." p. 13-21. Accessed Jan. 11, 2020.

1.2 Ndikimet e ndryshimit të klimës

Ndryshimet klimatike kanë pasur ndikim gati se në çdo fushë të jetës. Ndikimi i ndryshimit të klimës në burimet (resurset) ujore, ndikimi i ndryshimit të klimës në shëndetin publik, ndikimi i ndryshimit të klimës në bujqësi, ndikimi i ndryshimit të klimës në sektorin e energjisë, ndikimi i ndryshimit të klimës në ekosistemet dhe biodiversitetin.

1.2.1 Ndikimi i ndryshimit të klimës në burimet (resurset) ujore

Burimet ujore janë të rëndësishme si për shoqërinë ashtu edhe për ekosistemet. Në varami nga një furnizim i sigurt dhe i pastër i ujit të pijshëm për të ruajtur shëndetin tonë. Në gjithashtu kemi nevojë për ujë për bujqësi, prodhim të energjisë, lundrim, rekreacion dhe prodhim. Shkenctarët e klimës kanë parapa se efektet kryesore të ndryshimit të klimës do të jenë prishja e ciklit të ujit. Sipas hulumtimit të NASA-s, pesë vitet e fundit janë konsideruar si më të nxehtat në historinë e vëzhgimeve. Ndër pasojat e pashmangshme të ndryshimit të klimës, më e rëndësishmja është ndikimi i tij në burimet ujore - baza e mirëqenies mjedisore, rritja ekonomike dhe siguria globale.⁴⁹

Ndryshimet klimatike rrezikojnë sigurinë e ujit, ushqimit dhe sistemeve të energjisë, prishin ciklin e ujit dhe reshjet. Temperaturat e ngrohta rrisin shpejtësinë e avullimit të ujit në atmosferë. Avullimi i shtuar mund të thajë disa zona dhe disa në zona të tjera të bjerë reshje të tepërta, si dhe avullimi i shtuar rezulton në humbjen e ujit në tokë dhe bimë. Temperaturat e ngrohta gjatë sezonës së dimrit, bëjnë që më shumë të bjere shi se sa bore, si dhe bora që bije, për shkak të temperaturave të ngrohta, fillon të shkrihet në fillim të vitit. Kjo ndryshon kohën e rrjedhës së lumenjve që kanë burimet e tyre në zonat malore.⁵⁰ Ndryshimet klimatike rezultojnë në thatësira dhe përmbytje. Si pasojë e ndryshimeve klimatike kemi përmbytje dhe reshje ekstreme, të cilat rezultojnë në kosto të mëdha për sa i përket humbjes së jetës, infrastrukturës së shkatëruar dhe dëmtimit ekonomik.

Katër kryesuesit më të kushtueshëm ekonomikisht të motit në SH.B.A. dhe katastrofat klimatike, tre janë të lidhura me ujin:

- Ciklone tropikale (uragane) me 870,2 miliard dollarë;
- Thatësira me 241 miliard dollarë;

⁴⁹Water Scarcity, from: <https://www.beforetheflood.com/explore/the-crisis/water-scarcity-and-climate-change/>

⁵⁰USGCRP (2014). Georgakakos, A., P. Fleming, M. Dettinger, C. Peters-Lidard, Terese (T.C.) Richmond, K. Reckhow, K. White, and D. Yates. *Ch. 3: Water Resources. Climate Change Impacts in the United States: The Third National Climate Assessment*, J. M. Melillo, Terese (T.C.) Richmond, and G. W. Yohe, Eds., U.S. Global Change Research Program, 69-112.

- Stuhi të forta me 219 miliardë dollarë; dhe
- Përmbytja në tokë me 123 miliardë dollarë.⁵¹

Ndryshimet klimatike kanë ngrohur trupat ujorë dhe kanë bërë algat të shumohen dhe të bëhen problem I madh për lumenjtë, liqenet dhe oqeanet. Kjo rezulton si pasojë e ndotjes nga lëndët ushqyese dhe nga ujrate ngrohta. Algat e gjelbërta blu, mund të dëmtojnë jetën ujore dhe mund të prodhojnë toksina që janë të rrezikshme për njerëzit, kafshët, peshqit, për ujin e pijshëm si dhe për ekonominë dhe turizmin e një vendi. Shkrirja e akullnajave çon në uljen e furnizimit me ujë duke zvogëluar disponueshmërinë e ujit gjatë periudhave të ngrohta dhe të thata në rajonet e furnizuara me ujë të shkrirë nga vargmalet. Gjatë dekadës së kaluar, vëllimi i akullnajave Himalaje është ulur me dy të tretat, ndërsa akullnajat në Ande pothuajse janë zhdukur. Shkrirja e ngrirjes së përhershme çon në një rritje të rrëshqitjeve të tokës dhe në këtë mënyrë paraqet një kërcënim për infrastrukturën në rajonet e përhershme të ngrirjes.⁵²

Masat e parandalimit të rrezikut kanë për qëllim parandalimin e efekteve negative të ndryshimit të klimës në sektorin e ujit. Këto përfshijnë zvogëlimin e zhvillimit urban në zonat e prirura nga përmbytja, zhvillimin dhe zbatimin e teknologjive të kursimit të ujit në bujqësi dhe industri, rivendosjen dhe mbrojtjen e ligatinave dhe mbjelljen e pyjeve.⁵³Ndërtimi i infrastrukturës elastike ndaj klimës kërkon investime private dhe publike. Sipas Bankës Botërore, kostoja e përshtatjes së infrastrukturës ujore ndaj ndryshimeve klimatike në periudhën nga 2010 deri në 2050 vlerësohet në 75 miliardë dollarë në 100 miliardë dollarë në vit. Në vendet në zhvillim me infrastrukturë joadekuate ujore dhe rreziqe të larta klimatike, kjo shumë mund të rritet në 280 miliardë dollarë në 500 miliardë dollarë.⁵⁴

1.2.2 Ndikimi i ndryshimit të klimës në shëndetin publik

Me rritjen e temperaturave, ndotjen e ajrit, ndotjen e ujit, rritjen e frekuencës të disa ngjarjeve ekstreme të motit, dukshëm preket edhe shëndeti i njeriut, pasi këto ndikime kërcënojnë ushqimin që hamë, ujin që pimë, ajrin që thithim dhe motin që përjetojmë. Ashpërsia e këtyre rreziqeve shëndetësore do të varet nga aftësia e shëndetit publik dhe sistemeve të sigurisë për të adresuar ose përgatitur për këto kërcënime në ndryshim, si dhe faktorë të tillë si sjellja e një individi, moshë, gjinia dhe statusi ekonomik⁵⁵. Ndikimi nuk do të jetë i njëjtë për gjithë njerëzit, varësisht motit ku jeton dhe sa janë në gjendje të përshtaten ndryshimeve. Më të rrezikuar mund të jeshin njerëzit që jetojnë në zonat Veriore, ata të cilët nuk janë të mësuar të jetojnë me temperaturë të nxehta, fëmijët, të moshuarit si, gratë shtatzanë, persona me aftësi të kufizuara dhe

⁵¹ Watercalculator.org/footprint/climate-change-water-resources/

⁵² Impact of climate change by: Alexander Yuryev <https://www.wateronline.com/doc/impact-of-climate-change-on-water-resources-0001>

⁵³ Climate change and water resources, WaterAid, from: <https://washmatters.org/wateraid.org/publications/climate-change-and-water-resources>

⁵⁴ UNEP report: Cost of adapting to climate change could hit \$500B per year by 2050, from:

⁵⁵ <https://19january2017snapshot.epa.gov/climate-impacts/climate-impacts-human-health.html>

njerëzit e varfër. Ndryshimi i motit mundet të çojë në sulme të astmës dhe pasoja tjera shëndetësore, por më shumë kardiovaskulare. Përqendrimit më të larta të polenit dhe sezonet më të gjata të polenit mund të rrisin ndjeshmërinë alergjike dhe episodet e astmës.⁵⁶

Për shkak të ndotjes së ajrit dhe rritjes së nivelit të gazrave sere, si CO₂ dhe Ozon, Ozoni paraqitet të jetë shumë I rrezikshëm, pasi dëmton indin e mushkërive, zvogëlon funksioni e mushkërive. Përqendrimit më të larta të ozonit për shkak të ndryshimit të klimës mund të rezultojnë në dhjetëra deri në mijëra sëmundje shtesë të lidhura me ozonin dhe vdekje të parakohshme në vit deri në vitin 2030.⁵⁷ Grimcat e tilla që krijohen nga njeriu duke djegur lëndë fosile paraqiten të jenë shumë të dëmshme nëqoftëse thithen nga njeriu, duke rezultuar në sëmundje serioze si kanceri i mushkërive, sëmundjen pulmonare obstruktive kronike (COPD) dhe sëmundjet kardiovaskulare. Ndryshimet ekstreme të motit si stuhi, thatësira, rreshje ekstreme, përmytje kërcënojnë shëndetin e njeriut gjatë dhe pas ndodhisë. Kërcënimet e tilla ndikojnë në reduktim të disponueshmërisë së ushqimit të sigurtë dhe ujit të pijshëm, dëmtimi I rrugëve, urave, institucioneve shëndetësore, ritja e sëmundjes së stomakut dhe zorrëve si dhe krijimi ose përkeqësimi i shëndetit psikik të tilla si depresioni dhe cregullimi I stresit post-traumatik.⁵⁸

Grimcat nga tymi i zjarrit, barten në distance shumë të gjata nga era, dhe prekin njerëzit që qëndrojnë larg burimit të këtij ndotësi të ajrit. Ndryshimet në temperaturë, reshje dhe ngjarje ekstreme rrit gamën gjeografike të sëmundjeve të përhapura nga vektorët.⁵⁹ Sëmundja e njohur e virusit Nilit Perëndimor përhapet nga mushkojat të cilat lulëzojnë në mote ekstreme, në temperature shumë të ftohta, të nxehta, të lagura ose të thata. Dimrat e ngrohtë, sezoni më i gjatë pa ngrica dhe ardhja e hershme e pranverës mund të ndikojnë në modelet e migrimit dhe mbijetesën e re të shpendëve që janë strehuesi natyror i virusit të Nilit Perëndimor, pasi virusi ruhet në ciklet e transmetimit midis zogjve dhe mushkonjave. Mushkonja që më pare e ka kafshuar një zog të infektuar, mund të infektoj njeriun. Më shumë se tre million njerëz janë infektuar me virusi e Nilit Perëndimor në SHBA nga 1999-2010. Si sëmundje tjetër përmendet edhe sëmundja e Lyme që ngjitet nga këpushat, e cila bëhet më aktive me rritjen e temperatures.⁶⁰

Me rritjen e temperatures, ndotet uji dhe nuk kemi në disponim ujë të pijshëm. Pasi uji dotë jetë me bakterie dhe toksina e prodhuara nga alga të caktuara të dëmshme dhe cianobakteret dhe nga

⁵⁶ Air Quality Impacts <https://health2016.globalchange.gov/>

⁵⁷USGCRP (2016). *Impacts of Climate Change on Human Health in the United States: A Scientific Assessment*. Crimmins, A., J. Balbus, J.L. Gamble, C.B. Beard, J.E. Bell, D. Dodgen, R.J. Eisen, N.Fann, M.D. Hawkins, S.C. Herring, L. Jantarasami, D.M. Mills, S. Saha, M.C. Sarofim, J.Trtnanj, and L.Ziska, Eds. U.S. Global Change Research Program, Washington, DC. 312 pp. dx.doi.org/10.7930/J0R49NQX.

⁵⁸USGCRP (2016). *Impacts of Climate Change on Human Health in the United States: A Scientific Assessment*. Crimmins, A., J. Balbus, J.L. Gamble, C.B. Beard, J.E. Bell, D. Dodgen, R.J. Eisen, N.Fann, M.D. Hawkins, S.C. Herring, L. Jantarasami, D.M. Mills, S. Saha, M.C. Sarofim, J.Trtnanj, and L.Ziska, Eds. U.S. Global Change Research Program, Washington, DC. 312 pp. dx.doi.org/10.7930/J0R49NQX

⁵⁹ Vektorët janë organizma të gjallë që mund të transmetojnë sëmundje infektive midis njerëzve ose nga kafshët tek njerëzit. Shumë prej këtyre vektorëve janë insekte gjakpirëse.

⁶⁰https://19january2017snapshot.epa.gov/climate-impacts/climate-impacts-human-health_.html

kimikatet e futura në mjedis nga aktivitetet njerëzore⁶¹ kjo do rezultoj në sëmundje gastrointestinale si diarre, efekte në sistemin nervor dhe të frymëmarrjes së trupit, ose dëmtim të mëlçisë dhe veshkave. Ndryshimi i klimës do të rrit rrezikun e ekspozimit ndaj ndotësve kimikë në ushqim . Përqendrime më të larta të dioksidit të karbonit në ajër mund të veprojnë si një "pleh" për disa bimë, por ul nivelet e proteinave dhe mineraleve thelbësore në kultura të tilla si gruri, orizi dhe patatet, duke i bërë këto ushqime më pak të ushqyeshme.

Ngjarjet ekstreme shkaktojnë dëmë ujore dhe rrugore, dhe kjo mund të cojë deri në atë ku ushqimet bëhen të paaritshme për shkak se transporti bëhet i pamundur. Nryshimet në temperaturë dhe reshjet, si dhe thatësira dhe përmytje, do të ndikojnë në rendimentet bujqësore dhe prodhimin.⁶² Në disa rajone të botës, këto ndikime mund të rrezikojnë sigurinë ushqimore dhe të kërcënojnë shëndetin e njeriut përmes kequshqyerjes, përhapjes së sëmundjeve infektive dhe helmimit nga ushqimi. Efektet më të këqija parashikohet të ndodhin në vendet në zhvillim, në mesin e popullatave në nevojë⁶³. Rënia e shëndetit të njeriut në vendet e tjera mund të ndikojë në Shtetet e Bashkuara përmes tregtisë, migrimit dhe imigrimit dhe ka pasoja për sigurinë kombëtare.

Në këtë rast vlen të përmendet Fabrika Jugohrom Ferroalloys DOO Jegunovce e vendosur në fshatin maqedonas Jegunovce, në rajonin e luginës së Pollogut, rreth 10 km nga qyteti i Tetovës, e cila prodhon aliazh ferro, veçanërisht hekur-silic, periferisht 6 ton hekur secilin muaj. Kompania ka një histori mbi 50 vjet të hedhjes së pakontrolluar të materialit të mbeturinave që përmbajnë kripëra kromi shkaktuar ndotjen e tokës dhe ujërave nëntokësore, duke përfshirë lumin Vardar, një lumë i rëndësishëm ndërkuftar. Sidoqoftë problemi më i madh mjedisor është ndotja jashtëzakonisht e lartë e ajrit. Siç është identifikuar nga ekspertë dhe aktivistë të OJQ-ve, Jugohrom kontribuon pothuajse 99% në ndotjen totale të ajrit në rajonin e Pollogut. Sipas standardeve të Organizatës Botërore të Shëndetësisë (OBSH), përqendrimi i grimcave të grimcave PM10 është tetë herë më i lartë se kufijtë e lejuar, dhe më shumë se dhjetë herë në dimër, duke shkaktuar infeksione të frymëmarrjes, sëmundje të zemrës, goditje në tru, kancer dhe vdekje.⁶⁴

Ndikimet e saj në mjedis janë: ndotja e ajrit, Pasiguria e ushqimit (dëmtimi i të korrave), Ndotja e tokës, Ndotja e ujit sipërfaqësor, Humbja e biodiversitetit (jeta e egër, agro-diversiteti).

⁶¹ Climate and Health assessment Water related illness <https://health2016.globalchange.gov/>

⁶² USDA (2015). *Climate Change, Global Food Security, and the U.S. Food System*. Brown, M.E., J.M. Antle, P. Backlund, E.R. Carr, W.E. Easterling, M.K. Walsh, C. Ammann, W. Attavanich, C.B. Barrett, M.F. Bellemare, V. Dancheck, C. Funk, K. Grace, J.S.I. Ingram, H. Jiang, H. Maletta, T. Mata, A. Murray, M. Ngugi, D. Ojima, B. O'Neill, and C. Tebaldi, 146 p.

⁶³ IPCC (2014). *Climate Change 2014: Synthesis Report*. Contribution of Working Groups I, II and III to the Fifth Assessment Report of the Intergovernmental Panel on Climate Change [Core Writing Team, R.K. Pachauri and L.A. Meyer (eds.)]. IPCC, Geneva, Switzerland, 151 p. (PDF, 80 pp, 4.6MB).

⁶⁴ Atlas of Environmental Justice / [La contaminación atmosférica de Jugohrom-Jegunovce, Macedonia | EJAtlas23-05-2016](#)

Ndikimet socio-ekonomike Të dukshme: Rritja e korrupsionit, Kooptimi i aktorëve të ndryshëm, Mungesa e sigurisë në punë, mungesa e punës, largimet nga puna, papunësia, Shkeljet e të drejtave të njeriut, Humbja e peizazhit.

Meqënëse punën që bënin e kryenin pa përgjegjësi, qeveria e RMV kërkoi që Jugohrom të ndermer masa për vënien e filtrave si dhe të punojë me 50% të kapacitetit të saj të prodhimit që duhet të zvogëlojë emetimet e ndotjes me 60-70% për të cilën i caktoi afat kohor, me qëllim që të mos mbyllet dhe të mos lej 1200 punëtorë pa punë. Mbrenda afatit kohor, kompania nuk respektoi rregullat, andaj qeveria njoftoi mbylljen e fabrikës, më 15 Tetor 2015. Në janar 2016, Jugohrom mbylli vullnetarisht operacionet për dy muaj me qëllim të uljes së ndotjes së ajrit në Tetovë. OJQ-ja Eko Guerile tha se mbyllja e Jugohrom kishte rezultate pozitive për cilësinë e ajrit në qytet. Gjegjësisht, sipas matjeve të bëra nga ministria e mjedisit në vend, emetimet PM10 në shkurt 2016 u ulën me 41% krahasuar me nivelet e matura në Shkurt 2015. Për këto arsye, Eco Guerilla gjen të pajustificuar rihapjen e impiantit para se të plotësohen të gjitha standardet mjedisore.⁶⁵

1.2.3 Ndikimi i ndryshimit të klimës në bujqësi

Ndryshimet klimatike ndikojnë ashpër edhe fermerët. Ndryshimi i modeleve të temperaturës kërcënojnë jetesën e fermerëve dhe furnizimin me ushqim. Për më tepër, rritja e temperaturave ulin produktivitetin e bimëve. Nëqoftëse shikojmë nga ana pozitive, duket që ka mjete për të ju shmangur dhe për tu mbrojtur nga ndryshimet klimatike. Mirëpo fermerët e kanë të vështirë për të ndryshuar praktikën e tyre, që të përdorin mjete tjera, prandaj është kritike që politikëbërësit të zhvendosin investimet federale të bujqësisë për të mbështetur dhe përshpejtuar këtë tranzicion.

Përmbytjet e shpeshta në mbarë botën po prekin edhe rajonet bujqësore. Në rajonet bregdetare vecanërisht, rritja e nivelit të detit ngre frekuencën e dëmtimeve massive të fermave. Këto përmbytje dëmtojnë dhe shkatërojnë korrat, bagëtinë, përshpejtojnë erozionin e tokës dhe ndotin ujin. Thatësisirat gjithashtu dëmtojnë rënde tokat bujqësore, korrat, bagëtinë. Rritja e temperaturave do të shkaktojë thatësira edhe më të këqija, pasi ajo edhe rezulton në zjarre, i cili paraqitet të jetë shkatërrues për token.⁶⁶

Humbjet e korrave ose bagëtisë, ka gjasa të kenë efekte të ndryshme, duke përfshirë rritjen e cmimeve të ushqimeve (orizi, gruri, misri dhe farat e sojës) dhe pasigurinë e disoponueshmërisë së ushqimit. Tokat pjellore si humusi dhe torfe, të cilat janë të pasura me lëndë organike, janë në

⁶⁵Atlas of Environmental Justice / [La contaminación atmosférica de Jugohrom-Jegunovce, Macedonia | EJAtlas](#) / [Air pollution from Jugohrom-Jegunovce, Macedonia | EJAtlas](#)23-05-2016

⁶⁶ Union of Concerned Scientists <https://ucsusa.org/resources/climate-change-and-agriculture>

rrezik të erozionit për shkak të shpyllëzimeve, kullimit të ligatinave dhe menaxhimit të paqëndrueshëm të tokës.⁶⁷

Në pjesë të zonës mesdhetare, për shkak të nxehtësisë ekstreme dhe stresit të ujit në muajt e verës, disa të korra verore, tashmë mund të kultivohen në dimër, për shkak të ndryshimit të temperaturës. Disa fonde të BE-së, përfshirë Fondin Bujqësor Evropian për Zhvillimin Rural, Politikën e Përbashkët Bujqësore (CAP) dhe huatë nga Banka Evropiane e Investimeve, janë në dispozicion për të ndihmuar fermerët dhe komunitetet e peshkimit që të përshtaten me ndryshimet klimatike. Ka gjithashtu fonde të tjera nën CAP që synojnë të ndihmojnë në uljen e emetimeve të gazeve serë nga aktivitetet bujqësore.⁶⁸

1.2.4 Ndikimi i ndryshimit të klimës në sektorin e energjisë

Energjia paraqitet të jetë një faktor i rëndësishëm në jetët tona, pasi na shërben gati se në cdo hap të saj. Me përdorimin e energjisë elektrike ne gatuajm, ngrohemi, shfrytëzojmë transportin, ndricojmë vendin ku jetojmë e kështu me rradhë. Prodhimi dhe përdorimi i energjisë është një ndër faktorët më kontribues në rritjen e nivelit të emetimeve të gazrave sere, duke përbërë më shumë se 84% të gazrave sere.⁶⁹

Në një klimë më të ngrohtë, amerikanët do të përdorin më shumë energji elektrike për kondicionimin e ajrit dhe më pak gaz natyror, vaj dhe dru për ngrohje. Nëse klima e kombit ngroh me 1.8 ° F, kërkesa për energji e përdorur për ftohje pritet të rritet me rreth 5-20%, ndërsa kërkesa për energji e përdorur për ngrohje pritet të ulet me rreth 3-15%.⁷⁰

Sistemet e energjisë dhe ujit janë të lidhura. Energjia shërben edhe për ta trajtuar ujin e pijshëm dhe ujërat e zeza. Motet ekstreme ndikojnë në modelet e energjisë dhe përdorimit të ujit.

Temperaturat shumë të larta (të nxehta) ka mundësi të rrisin kërkesën për energji elektrike. Në këto zona, mund të mos kemi ujë të mjaftueshëm për shkak të rritjes së temperaturës dhe avullimit, si dhe uljes së mundshme të reshjeve. Meqënëse uji është i nevojshëm për prodhimin e energjisë, kjo paraqet telashe.

⁶⁷The impact of animal agriculture on climate change <https://proveg.com/uk/climate-change/>

⁶⁸ Agriculture and climate change <https://www.eea.europa.eu/signals/signals-2015/articles/agriculture-and-climate-change>

⁶⁹EPA (2015). *Inventory of U.S. Greenhouse Gas Emissions and Sinks: 1990-2013*. U.S. Environmental Protection Agency (EPA). EPA (2015). *Inventory of U.S. Greenhouse Gas Emissions and Sinks: 1990-2013*. U.S. Environmental Protection Agency (EPA).

⁷⁰CCSP (2008). *Effects of Climate Change on Energy Production and Use in the United States*. A Report by the U.S. Climate Change Science Program and the subcommittee on Global change Research. Wilbanks, T.J., V. Bhatt, D.E. Bilello, S.R. Bull, J.Ekmann, W.C. Horak, Y.J. Huang, M.D. Levine, M.J. Sale, D.K. Schmalzer, and M.J. Scott. Department of Energy, Office of Biological & Environmental Research, Washington, DC, USA.

Portet e karburantit dhe linjat e gjenerimit dhe transmetimit që sjellin energji elektrike në qendrat kryesore bregdetare urbane janë në rrezik. Ashpërsia e stuhive dhe ngjarjeve të tjera ekstreme mund të dëmtojnë gjithashtu infrastrukturën e energjisë, duke rezultuar në mungesa të energjisë që dëmtojnë ekonominë dhe prishin jetën e përditshme të njerëzve.⁷¹

Zonat bregdetare, me rritjen e nivelit të detit dhe duke u ekspozuar stuhive dhe uraganeve mund të rrezikohen me ndërprerje të furnizimit me energji, mund linjat e energjisë të dëmtohen dhe pajisjet e shpërndarjes së energjisë elektrike.

Sa i përket Republikës së Maqedonisë së Veriut prodhimi i energjisë në të bazohet më së shumti në linjit të brendshëm, lëndë djegëse të importuara, hidro potencial dhe dru, dhe të gjithë ato përdoren për prodhimin e energjisë elektrike dhe ngrohjes dhe energjisë mekanike në sektorin e transportit. Prodhimi i energjisë elektrike bazohet në termocentrale dhe hidrocentrale. Në periudhë 1990 - 2012, transporti rrugor ishte përgjegjës për 99% të emisioneve totale nga nënsektori i transportit.

1.2.5 Ndikimi i ndryshimit të klimës në ekosistemet dhe biodiversitetin

Një ekosistem i shëndetshëm do të thotë shumëllojshmëri të jetës së bimëve dhe kafshëve. Nëse një ose më shumë kafshë ose bimë zhduken nga ky mjedis, duke mos shërbyer më në tokë, kjo mund të dëmtojë ekosistemin. Ndryshimet klimatike luhatin biodiversitetin dhe ekosistemet, dhe kjo mund të dëmtojë shumë specie.

Humbja e biodiversitetit drejton rrezikun e pandemisë

Me humbjen e habitatit - për shembull, kthimi i zonave natyrore në qytete ose fusha bujqësore, kur njerëzit shndërrojnë livadhet në parkingje ose oborre ose mbjellja e tepërt dhe ndryshimet e tjera mjedisore të shkaktuara nga njerëzit - do rezultojnë në zvogëlimin e popullatës së polenizuesve. Nëse polenizuesit do të zhdukeshin tërësisht, ne do të humbim mbi një të tretën e të gjithë prodhimit bimor. Kjo do të zvogëlonte ose eliminonte disponueshmërinë e ushqimeve si mjalti, çokollata, manaferrat, arrat dhe kafeja.⁷²

⁷¹ Sea level Rise, Storm Surge, and Extreme Events <https://19january2017snapshot.epa.gov/climate-impacts/climate-impacts-energy.html#ref2>

⁷² State of the Planet – Earth Institute – What is Biodiversity and How does climate change affect it? <https://blogs.ei.columbia.edu/2018/01/15/biodiversity-climate-change/>

Shumë ilace moderne, si aspirina, kafeina dhe morfina, moderohen sipas përbërjeve kimike që gjenden në bimë. Nëse speciet e botës së egër zhduken, kjo do të pamundësojë prodhimin e barnave biologjike.⁷³

Ekosistemet më të prekshme përfshijnë ekosistemet bregdetare, zonat alpine, pyjet e shiut, ekosistemet tokësore të copëtuara dhe zonat e prekshme nga zjarri ose disponueshmëria e ulët e ujërave të ëmbla. Speciet që mund të rrezikohen ose të zhduken përfshijnë ato që jetojnë afër kufirit të sipërm të intervalit të tyre të temperaturës (për shembull, në rajone alpine); ata me kamare të kufizuara klimatike; dhe ata që nuk mund të migrojnë në habitate të reja për shkak të copëzimit të habitateve ose mungesës së alternativave.⁷⁴ Politikanët kanë propozuar disa marrëveshje ndërkombëtare për ta trajtuar këtë çështje. Për ta parandaluar këtë na duhen veëm ndërrime të sjelleve tona në përditshmërinë si përshebull shpëputje të pajisjeve nga ryma të cilat nuk përdoren, ndryshimi i llambave në LED, prodhimi i mishit në masë më të vogël me qëllim të zvogëlimit të emetimeve të gazrave sere dhe për ta shpëtuar biodiversitetin.

⁷³ State of the Planet – Earth Institute – What is Biodiversity and How does climate change affect it? <https://blogs.ei.columbia.edu/2018/01/15/biodiversity-climate-change/>

⁷⁴ Impacts of climate change on biodiversity <https://www.environment.nsw.gov.au/topics/animals-and-plants/biodiversity/about-biodiversity/climate-change-impacts>

Kapitulli i II - Pronësia intelektuale

2.1 Nocioni i pronësisë intelektuale

Pronësia intelektuale paraqitet të jetë krijimtari intelektuale e personit fizik apo juridik që paraqet produkt të mendjes apo tjetër, që ka zbatim në industri dhe ka karakter inventiv. Të drejtat e pronësisë intelektuale mbrojnë interesat e krijuesve, ua japin atyre të drejtën e pronës mbi krijimet e tyre dhe të drejtën në përfitime financiare nga shpikja apo krijimtarija e tyre.

Pronësia intelektuale është domosdoshmëri e patjetërsuar për zhvillimin e gjithëmbarshtëm të shoqërisë në aspektin teknologjik, ekonomik, kulturor dhe mirëqenies sociale. Rëndësia e pronës intelektuale u njoh së pari në konventën e Parisit për mbrojtjen e pronësisë industriale (1883) dhe Konventën e Bernës për Mbrojtjen e Veprave Letrare dhe Artistike (1886). Të dy traktatet administrohen nga Organizata Botërore e Pronësisë Intelektuale (WIPO).

Konventa e krijimit të Organizatës Botërore të Pronësisë Intelektuale (1967) jep listën e mëposhtme, të termave që mbrohen nga të drejtat e pronësisë intelektuale:

- Interpretimet e artistëve ekzekutues, fonogramet dhe transmetimet;
- Veprat letrare, artistike dhe shkencore;
- Mbrojtja kundër konkurrencës së pandershme;
- Markat tregtare, markat e shërbimeve, emrat komerciale dhe dizajnet;
- Zbulimet shkencore;
- Të gjitha të drejtat e tjera që vijnë nga aktiviteti intelektual në fushat industriale, shkencore, letrare ose artistike.⁷⁵

Të drejtat nga pronësia industriale janë: patenta, dizajni industrial, marka tregtare, shenja e prejardhjes dhe shenja gjeografike.

- Me patentë mbrohet shpikja.
- Me dizajnin industrial mbrohet forma e re e trupit, piktura, vizatimi, kontura, kompozicioni i ngjyrave dhe ose kombinimi-dizajni i tyre.
- Me markë tregtare mbrohet shenja tregtare.
- Me shenjën e prejardhjes dhe shenjën gjeografike mbrohet emri gjeografik.⁷⁶

⁷⁵ PRONËSIA INTELEKTUALE DHE INDUSTRIALE / KREU I - PRONËSIA INTELEKTUALE/ fq. 2 [Pronësia-intelektuale-dhe-industrial-Përmbajtja-e-modulit.pdf \(ascap.edu.al\)](#)

⁷⁶ LIGJ PËR PRONËSINË INDUSTRIALE PJESA E PARË DISPOZITAT E PËRGJITHSHME – NENI 2 FQ. 1

Në pikpamje të parë, të drejtatat e pronësisë intelektuale shihen si neutrale, pasi qëllimi i tyre është thjesht të japin një nxitje shpikësve për të shpikur teknologji të reja ose të krijojnë vepra origjinale. Në bazë të këtij arsytimi, kur njeriu e din se mund të fitoj ndonjë të drejtë ekskluzive nëse prodhon një produkt të ri ose vepër origjinale (e cila do të ketë shpërblime monetare) atë do të inkurajohet të krijojë ose të shpik ndonjë risi. Nën këtë arsyetim arrihet të kuptohet se me produkte më të mira bota do të duket më mirë (si psh: me ilaçe më të mira, me makina më të mira) dhe me më shumë diversitet kulturor.⁷⁷

Arsytimi tjetër kryesor për patentat dhe të drejtat e autorit është se ato janë të drejta natyrore. Është e natyrshme që shpikësi i një produkti të fitoj të drejtat intelektuale si dhe frytet e punës së tij ose saj. Këto të drejta janë edhe të drejta të njeriut bazuar në faktin se ato janë të drejta pronësore, megjithëse intelektuale. Sipas teorisë së të drejtave natyrore, duket se çdo shpikës ose krijuesi duhet të ketë një të drejtë prone në punën e tij intelektuale, cilado qoftë pasoja që ka ajo në ngrohjen globale. Mirëpo kjo e drejtë duhet të kufizohet, pasi shpikësi ose krijuesi në momentin kur krijon dicka, duhet të merr parasysh se produkti çfarë ndikimi do të ketë në mjedis.

Regullimi juridik i në nivel ndërkombëtar dhe nacional i mënyrës së përdorimit të pronësisë intelektuale mund të ndikojnë në eliminimin e pasojave negative të tyre në ndryshimet klimatike. Të drejtat e pronësisë intelektuale nuk duhet të dëmtojnë mjedisin dhe, më konkretisht, të rrisin nivelet e CO₂, pasi që kjo pa dyshim nuk gjeneron mirëqenie sociale. Ideja qëndron në atë se këto të drejta duhet të promovojnë përparimin apo progresin. Nën një vështrim të caktuar ky progres mund të përfshijë përmisimin e jetës njerëzore. Prandaj, përsëri, duhet të nënkuptojë që patentat dhe të drejtat e autorit nuk duhet të jepen për shpikje dhe krijime që rrisin nivelet e CO₂ në atmosferë nëse kjo çon në ngrohjen globale. Ose të paktën duhet të bëhet një ekuilibër midis përfitimeve të shpikjes / krijimit dhe ndikimit të këtyre shpikjeve në rritjen e niveleve të karbonit.⁷⁸

Duhet të cekur se të drejtat e pronësisë intelektuale janë të rrëndësishme për ndryshimet klimatike. Inovacioni dhe krijmataria mund të na çojnë në produkte dhe procese të reja që mund të ndihmojnë në përgjigjen ndaj ndryshimeve klimatike. Duke vendosur balancin e duhur mes interesave të inovatorëve dhe interesit më të gjërë publik, sistemi i Pronësisë Intelektuale synon të nxisë një mjedis në të cilën krijmataria dhe inovacioni mund të lulëzojnë, për të mirën e të gjithëve.

Para së gjithash, në rradhë të parë janë patentat që merren me mjedisin, pasi ato mbrojnë shpikjet që mund të kenë ndikim negativ në mjedis siç janë makinat e reja, aeroplanët, trenat dhe më përgjithësisht produktet, makinat ose proceset që gjenerojnë CO₂.

⁷⁷Ky argument bazohet në parimin e shërbimeve dhe shkrimit e filozofëve dhe ekonomistëve të shekullit XIX dhe XIX, Jeremy Bentham dhe John Stuart Mill.

⁷⁸INTELLECTUAL PROPERTY RIGHTS AND GLOBAL WARMING - Rationales for Intellectual Property Protection, page 265

Të drejtat ekskluzive të dhëna nga patentat mund të përfshin teknologji që mundësojnë gjenerimin e energjisë së rinovueshme, ilace për sëmundje të reja që shfaqen si rezultat i ndryshimeve klimatike. Softueri kompjuterik gjithashtu paraqitet të jetë efektiv në përpjekjet për të mbrojtur mjedisin, pasi që ai mund të përdoret për matje dhe vlersime të ndryshimit të klimës dhe nivelin e detit, dhe paraqitet si mundësi që energjia të lëvizë rreth rrjetit në mënyrë efektive dhe efikase, kultura të reja rezistente ndaj thatësirës dhe mbrojtje nga përmbytja.⁷⁹ Ligjet e PI nuk merren drepërdrejt me detyrimet ndërkomëtare të transferimit të teknologjisë së shteteve, andaj duhet të egzistojë përgjegjësia e vet shtetit në drejtim të zvogëlimit të të emetimeve dhe transferimit të teknologjisë si dhe të miratojnë ligje për të kufizuar ushtrimin e të drejtave të PI.⁸⁰

Lidhur me të drejtat e Pronësisë Intelektuale egziston një marrëveshje “Marrëveshja mbi Aspektet e Lidhura me Tregtinë e Pronës Intelektuale (TRIPS)” e cila hyri në fuqi në 1994 që nënkupton një marrëveshje mbi aspektet tregtare të lidhura me të drejtat e pronësisë intelektuale. Marrëveshja është marrëveshja e parë ndërkombëtare (e PI) përban dispozita të hollësishme civile, penale dhe dispozita të zbatimitin të kufirit në lidhje me pronën intelektuale. Marrëveshja TRIPS u lejon anëtarëve të saj të sigurojnë mbrojtje më të gjerë të pronës intelektuale nëse ata e dëshirojnë këtë.

Neni 7 i Marrëveshjes të vitit 1994 mbi Aspektet e Tregtisë së të Drejtave të Pronësisë Intelektuale (TRIP) përmend se mbrojtja dhe zbatimi i të Drejtave të Pronësisë Intelektuale duhet të kontribuojë në mirëqenien sociale dhe ekonomike, duke mbështetur, megjithëse jo shprehimisht, një ulje të emetimeve të karbonit nëse kjo është e favorshme për mirëqenien sociale dhe ekonomike. Shtetet që janë palë të marrëveshjes së lartë përmendur, duhet të përmbushin detyrimet e tyre për të mbrojtur të drejtat e PI, nëse këtë nuk e bën ndonjëri nga shtetet, atëherë një shteti tjetër, ka të drejtë ankese tek Organi për Zgjidhjen e Mosmarrëveshjeve të OBT-së.

TRIPs në dispozitat hyrëse parashikon se shtetet duhet të kontribojnë në promovimin e inovacionit dhe transferimin e teknologjisë, parashikon ndihmë teknike dhe financiare për vendet në zhvillim dhe ato më pak të zhvilluara në lidhje me PI dhe zbatimin e saj.⁸¹ Meqënëse ngrohja globale është problematik e rre, është e logjikshme se konventat e vjetra nuk e adresojnë këtë problem në mënyre specifike. Sidoqoftë, Konventa e Parisit për Mbrojtjen e Pronësisë Industriale të vitit 1883, konventa më e vjetër dhe më kryesore për patentat, përmban një dispozitë të përgjithshme që urdhëron pronarët e patentave që të krijojnë produkte që do të jenë miqësore për mjedisin. Meqënëse është ma e rreja TRIPS adreson drejtpërdrejt shqetsimet mjedisore.

⁷⁹ Intellectual Property and Climate Change Abbe EL Brown The Oxford Handbook of Intellectual Property Law Edited by Rochelle Dreyfuss and Justine Pila. Legal Landscape: Phase 1 4.1 Intellectual Property, Secrecy, and Information—With a Climate Change Focus, page 5.

⁸⁰ Intellectual Property and Climate Change Abbe EL Brown The Oxford Handbook of Intellectual Property Law Edited by Rochelle Dreyfuss and Justine Pila

⁸¹ TRIPS, arts 66(2) and 67.

Dispozitat e përgjithshme të Konventës të kombinuara së Parisit si dhe TRIP potencojnë se të drejtat e PI nuk duhet të keqperdoren. Mbrenda instrumenteve ndërkombëtare të PI egzistojnë disa dispozita specifike të cilat egzistojnë edhe në Ligjin Europian. Dy dispozitat e para janë morali dhe rendi publik, ku potencohet se një shpikje nuk mundet të jetë në kundërshtim me Rendin publik dhe Moralin. Si shembull i shpikjeve të tilla (që janë në kundërshtim me Rendin Publik dhe moralin) mund të jenë:

- një shpikje që paraqet një proces për klonimin e qenieve njerëzore;
- një shpikje që paraqet një proces për modifikimin e identitetit gjenetik të linjës embrionale të qenieve njerëzore;
- një shpikje që përfshin përdorimin e embrioneve njerëzore për qëllime industriale ose tregtare;
- një shpikje që jepet për të inkurajojë sjellje fyese, imorale ose antisociale.⁸²

2.2 Pronësia intelektuale si mekanizëm i interesit publik

Pronësisë intelektuale duhet të balancojnë mbrojtjen dhe zbatimin e të drejtave të pronësisë intelektuale me konsideratat e interesit publik. Neni 7 i Marrëveshjes TRIPS njih këtë ekuilibër, duke siguruar që "mbrojtja dhe zbatimi i të drejtave të pronësisë intelektuale duhet të kontribuojë në promovimin e inovacionit teknologjik dhe në transferimin dhe shpërndarjen e teknologjisë, në avantazhin e ndërsjellë të prodhuesve dhe përdoruesve të njohurive teknologjike dhe në një mënyrë të favorshme për mirëqenien sociale dhe ekonomike dhe për një ekuilibër të të drejtave dhe detyrimeve".⁸³

Për shkak të mbrojtjes së jetës dhe shëndetit të njerëzve dhe mjedisit jetësor, ministri i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për punët nga lëmi i mjedisit jetësor, në pajtim me ministrin i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për punët nga lëmi i ekonomisë, ministrin i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për punët nga lëmi i bujqësisë, pylltarisë dhe ekonomisë së ujërave dhe ministrin i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për punët nga lëmi i shëndetësisë, e kufizon ose ndalon importin dhe eksportin e substancave të rrezikshme, materieve dhe prodhimeve të dëmshme në Republikën e Maqedonisë.⁸⁴

⁸² Intellectual Property and Climate Change Abbe EL Brown The Oxford Handbook of Intellectual Property Law Edited by Rochelle Dreyfuss and Justine Pila. Legal Landscape: Phase 1 4.1 Intellectual Property, Secrecy, and Information—With a Climate Change Focus

⁸³ AGREEMENT ON TRADE-RELATED ASPECTS OF INTELLECTUAL PROPERTY RIGHTS Article 7 Objectives page number 5 http://www.tripsagreement.net/trips_files/documents/TRIPS_E.pdf

⁸⁴ LIGJ PËR MJEDISIN JETËSOR TEKST I KONSOLIDUAR I I. DISPOZITAT E PËRGJITHSHME Neni 22 Përkufizimi dhe kontrollimi i eksportit dhe importit të substancave dhe prodhimeve të caktuara

2.3 Pronësia intelektuale dhe të drejtat e njeriut

Të drejtat e pronësisë intelektuale përbëhen nga të drejta të njohura nga statuti, duke siguruar stimuj për pjesëmarrjen e sektorit privat në fusha të ndryshme dhe kërkojnë të kontribuojnë në zhvillimin teknologjik. Nga ana tjetër, të drejtat e njeriut janë të drejtat themelore, të cilat njihen nga shteti, dhe janë të drejta të qenësishme të lidhura me dinjitetin njerëzor. Pra të drejtat e pronësisë intelektuale janë të drejta që i jepen një shpikësi ose krijuesi si shpërblim për shpikjen e dickaje të re, si dhe nga ajo shpikja përfiton shoqëria.

Ndërsa të drejtat e njeriut u jepet qenie njerëzore jo për ndonjë rast ose si shpërblim, po vetëm nga fakti i të qenurit njeri. Ata janë të drejta që sigurojnë mbijetesën themelore të qenieve njerëzore. Prona Intelektuale tashmë ka gjetur rrugën e saj në të drejtat e njeriut. E drejta për pronësi intelektuale futet në Deklaratën universale të të drejtave të njeriut (UDHR) dhe Deklaratën e Kombeve të Bashkuara për të drejtën e njerëzve vendas (UNDRIP). Neni 27 (2) UDHR thotë se "... të gjithë kanë të drejtën e mbrojtjes së interesave morale dhe materiale që rezultojnë nga çdo prodhim shkencor, letrar ose artistik i të cilit është autori."⁸⁵ Si dhe Neni 27.1 i UDHR-së thotë qartë se "të gjithë kanë të drejtë të marrin pjesë lirisht në jetën kulturore të komunitetit, të gëzojnë artet dhe të marrin pjesë në përparimin shkencor dhe përfitimet e tij" dhe neni 27.2 i UDHR-së, thotë se "të gjithë ka të drejtën për mbrojtjen e interesave morale dhe materiale që rezultojnë nga çdo prodhim shkencor, letrar ose artistik, autor i të cilit është."⁸⁶

Lidhur me të drejtën e njeriut për shëndet, lidhja midis të drejtave të pronës intelektuale dhe të drejtave të njeriut është bërë e dukshme në marrëdhëniet midis patentave mjekësore dhe të drejtës për shëndet, veçanërisht në lidhje me epidemitë e HIV / AIDS. Kjo për faktin se një numër ilaçesh të përdorura për të lehtësuar HIV / AIDS mbrohen nga patentat. Prandaj, ekziston një lidhje e drejtpërdrejtë midis patentave, çmimit të barnave dhe aksesit në barna.

2.4 Roli i pronësisë intelektuale në zhvillimin ekonomik

Pronësia intelektuale (PI) kontribon dhe luan rol kryesor në rritjen e bizneseve dhe zhvillimin ekonomik. E gjithë ekonomia mbështetet në një formë të pronësisë intelektuale. Të drejta të pronësisë intelektuale më të forta dhe të sigurta nxisin ndryshime të dobishme teknike, duke përmisuar prespektivat e zhvillimit. Të drejta të pronësisë intelektuale janë pjesë e infrastrukturës institucionale që inkurajon investimet private në kërkimin dhe zhvillimin zyrtar dhe aktivitete të tjera krijuese.

⁸⁵Universal Declaration of Human Rights article 27 page 7

https://www.ohchr.org/EN/UDHR/Documents/UDHR_Translations/eng.pdf

⁸⁶<https://legaldesire.com/human-rights-and-intellectual-property-rights/>

Shfaqja e teknologjive të reja ka çuar në përshtatjen e vazhdueshme të instrumenteve të mbrojtjes së te DPI. Për shembull, evolucioni i mbrojtjes së DPI në lidhje me bioteknologjinë dhe implikimet e saj për bujqësinë dhe industrinë farmaceutike përfaqëson një fushë të re të rëndësishme që është me rëndësi të madhe për vendet në zhvillim. Shembuj të tjerë përfshijnë mbrojtjen e softverit kompjuterik dhe mbrojtjen e informacionit në një mjedis dixhital siç është interneti. Rëndësia e të drejtave të pronësisë intelektuale në aktivitetin ekonomik ndryshon në të gjithë vendet dhe varet nga sasia e burimeve që vendet i kushtojnë krijimit të pasurive intelektuale.

2.5 Struktura themelore e pronësisë intelektuale ne RMV

Neni 3 i Ligjit të pronësisë intelektuale në Republikën e Maqedonisë së Veriut, të drejtat nga pronësia industriale i përkufizon si të drejta nga krijime intelektuale dhe lidhje ekonomike nga lëmi e industrisë dhe tregtisë, duke përfshirë edhe bujqësinë.

Strukturën themelore të Pronësisë intelektuale e përbejnë:

- patenta - mbrohet shpikja;
- dizajni industrial - mbrohet forma e re e trupit, piktura, vizatimi, kontura, kompozicioni i ngjyrave dhe ose kombinimi-dizajni i tyre;
- marka tregtare - mbrohet shenja tregtare;
- shenja e prejardhjes dhe shenja gjeografike - mbrohet emri gjeografik.

Neni 3 i Ligjit të pronësisë intelektuale në Republikën e Maqedonisë, përcakton subjektet e të drejtave të cilët mund të jenë: persona juridik dhe persona fizikë të vendit apo të huaj. Personat e huaj fizikë apo juridikë i gëzojnë të drejtat e njeta si personat vendorë. Shpikësi i patentës ka të drejta ekskluzive dhe morale. Të drejtat morale lidhen me personalitetin e bartësit të se drejtës.

Të drejta ekskluzive sipas nenit 8 (1) - e drejta ekzkluzive e bartësit të patentës, dizajnit industrial dhe markës tregtare, e përfshin të drejtën e shfrytëzimit, e disponimit, të drejtën e kompensimit dhe të drejtën që t'ua ndalojë personave të tretë, shfrytëzimin e paautorizuar në rastet dhë në mënyrë që janë paraparë me marrëveshje dhe konventa ndërkombëtare, me këtë ligj, me ligj tjetër dhe me marrëveshje. (2) Bartësit e markës tregtare kolektive dhe shfrytëzuesit e autorizuar të shenjës së prejardhjes dhe shenjës gjeografike, i gëzojnë të drejtat nga paragrafi (1) i këtij neni, përveç të drejtës për disponim.⁸⁷

Punët në lidhje me marrjen dhe mbrojtjen e të drejtave nga pronësia industriale, i kryen Enti shtetëror për pronësi industrial. Enti është organizatë administrative me status të organit të pavarur të administratës shtetërore, me kompetenca të përcaktuara me këtë ligj dhe ligj tjetër. Enti ka cilësi të personit juridik. Selia e Entit është në Shkup.

⁸⁷ LIGJ PËR PRONËSINË INDUSTRIALE, NENI 8.

Enti shtetëror financohet nga të hyrat e veta, ndërsa nëse nevojiten mjete plotësuese edhe nga buxheti i Republikës së Maqedonisë. Mbrojtja e të drejtave të pronësisë industriale në Republikën e Maqedonisë, kërkohet me parashtrim të fletëparaqitjes përkatëse në Ent. Për fitimin dhe mbajtjen e të drejtave nga pronësia industriale paguhen taksa në pajtim me Ligjin për taksa administrative, si dhe shpenzime të veçanta të procedurës për pranimin e së drejtës. Lartësinë e shpenzimeve të veçanta të procedurës e miraton drejtori i Entit me tarifë për të cilën jep pëlqim Qeveria e Republikës së Maqedonisë.⁸⁸

2.5.1 Patentet

Patenti është e drejtë e shpikjes dhe zbulimit e cila shfaqet si fomë e vacant dhe gëzon mbrojtje ligjore. Patenti është dokument i shkruar, të cilën me kërkesë të personit të caktuar e lëshon organi kompetent dhe paraqet provë se personi i caktuar është bartës i rregullt i patentit në kuptimin material.⁸⁹ Që të mund të jetë a patentuar zbulimi, krijimi apo shpikja ajo duhet të jetë diçka e re (risi), të përmbaj kontribut inventive dhe të mund të përdoret në industri.⁹⁰

Neni 23 i Ligjit të PI në RMV: Me patentë mbrohet shpikja në të gjitha sferat e teknologjisë, nëse është i rinëse përmban kontribut inventiv dhe nëse mundet të zbatohet në industri. Me patentë mbrohet dhe shpikja që ka të bëj me: prodhimin që përbëhet ose përmban material biologjik dhe -procedurën për fitimin e materialit biologjik, përpunimin ose përdorimin e tij.⁹¹

Nuk llogaritet shpikje sipas Ligjit të PI në RMV:

- 1) shpikja, teoria shkencore dhe metoda matematikore;
- 2) krijimi estetik;
- 3) plani, rregulla dhe procedura për kryerjen e veprimtarisë intelektuale, për lojëra ose për kryerjen e aktiviteteve afariste ose të biznesit, si dhe programi kompjuterik;
- 4) paraqitja e i informacioneve, dhe
- 5) trupi i njeriut në faza të ndryshme të formimit dhe të dhe zhvillimit të tij, ose shpikje e thjeshtë të njerit nga elementet e tij, duke përfshirë sekuencë ose sekuencë të pjesëshme të gjenit.

⁸⁸ LIGJ PËR PRONËSINË INDUSTRIALE.

⁸⁹ S.Markoviq, Patentno pravo, Beograd, 1997

⁹⁰ Ligji mbi pronesine industrial, neni 25

⁹¹ LIGJ PËR PRONËSINË INDUSTRIALE – PJESA E DYTE PATENTA

Përrjashtime nga mbrojta e patentës sipas Ligjit të PI në RMV, shpikjet që nuk mund të mbrohen me patentë:

- që ka të bëjë me llojet e reja të kafshëve dhe sojeve të bimëve dhe procedurat biologjike të pastra për fitim të kafshëve dhe bimëve, përveç për shpikjet bioteknologjike, shpikjet realizimi teknik i të cilave nuk është i kufizuar në lloj të caktuar, ose nëse bëhet fjalë për procese mikrobiologjike dhe për prodhime të fituara nga ato procese;

- për procedurë kirurgjike dhe diagnostike, ose procedurë për trajtim trupit të njeriut ose kafshës së gjallë, me përjashtim të shpikjes që ka të bëjë me prodhimin veçanërisht materie ose komponime të cilat shërbejnë për zbatimin e njëres nga këto veprime dhe - zbatimi i së cilës është në kundërshtim me rendin publik ose moralin, me çfarë zbatimi i shpikjes nuk mundet të llogaritet si i tillë veçanërisht për shkak të faktit se është e ndaluar me ligj,

- veçanërisht shpikjet që kanë të bëjnë me: proceset për klonimin dhe modifikimin e identitetit gjenetik në vijën e trashëgimisë së njeriut, shfrytëzimin e embrioneve të njeriut për qëllime industriale dhe komerciale, proceset për modifikimin e identitetit gjenetik të kafshëve, të cilat me siguri do t'u shkaktojnë vuajtje pa interes të rëndësishëm mjekësor për njeriun ose kafshën dhe gjithashtu kafshët, që janë rezultat i atyre proceseve.⁹²

Shpikës është personi fizik i cili e ka bërë shpikjen me punën e tij shpikëse. Nuk llogaritet si shpikës, ai i cili për krijimin e shpikjes ka dhënë vetëm ndihmë teknike. Trashëgimtari juridik i shpikësit është personi juridik ose fizik, njohja e të drejtës së patentës të të cilit bazohet në ligj, punë juridike, trashëgimi dhe vendim gjyqësor. Punëdhënësi llogaritet si trashëgimtar juridik i shpikësit, kur në bazë të ligjit ose marrëveshjes për punë, i takon e drejta e fitimit të patentës për shpikje, të krijuar në kuadër të marrëdhënies së punës së shpikësit.⁹³

Sipas Nenit 74 të ligjit të PI, e drejta e patentës vlen 20 vjet duke llogaritur nga dita e parashtrimit të fletëparaqitjes, mund të vazdhohet edhe mbi 20 vjet por jo më tepër se 5 vjet, , në rast kur lënda e patentit është produkt mjekësor, produkt për mbrojtjen e bimëve ose procedurat e fitimit të tyre, për të cilat para lëshimit në qarkullim është e nevojshme që të zbatohet procedura administrative juridike për miratim e përcaktuar me ligj. E drejta për patentë e fituar në bazë të aktvendimit nga neni 60 i këtij ligji, zgjat 10 vjet nga dita e parashtrimit të fletëparaqitjes.

Në shumicën e vendeve, të drejtat e patentës bien nën të drejtën private dhe mbajtësi i patentës duhet të padisë dikë që shkel patentën në mënyrë që të zbatohë të drejtat e tij ose të saj.⁹⁴

⁹²LIGJ PËR PRONËSINË INDUSTRIALE – PJESA E DYTE PATENTA Përrjashtime nga mbrojta e patentës NENI 26 fq.11

⁹³ LIGJ PËR PRONËSINË INDUSTRIALE – PJESA E DYTE PATENTA Neni 32

⁹⁴ [WIPO Intellectual Property Handbook: Policy, Law and Use. Chapter 2: Fields of Intellectual Property Protection Archived 2013-05-20 at the Wayback Machine](#) WIPO 2008

Sipas Marrëveshjes TRIP të Organizatës Botërore të Tregtisë (OBT), patentat duhet të jenë të disponueshme në vendet anëtare të OBT-së për çdo shpikje, në të gjitha fushat e teknologjisë, me kusht që të jenë të reja, të përfshijnë një hap shpikës dhe të jenë të afta për zbatim industrial.⁹⁵Në artikullin 27 të TRIP gjenden dispozitat për respektimin e mjedisit si dhe e tregon në mënyrë të specifike problemin e ngrohjes globale. Paragrafi 1 i nenit 27 thjesht detyron anëtarët për të siguruar që patentat mund të jepen në të gjitha fushat teknologjisë.Paragrafi i dytë për një periudhë të gjatë kohore, tashmë është konstatuar se asnjë e drejtë e PI nuk mund të jepet për shpikje ose krijime imorale. Mirëpo, në nenin 27 nuk jepet një standart të qartë për të vlersuar kur egziston një dëm serioz ndaj mjedisit. Neni e bën të qartë se dëmi duhet të jetë serioz por ky seriozitet mbetet akoma i pa qartë.Anëtarët e zyrave të patentave të cilet e në ligjet e tyre e përfshin nenin 27, duhet të vlersojnë shpikja ose krijimi i ri në të vërtetë e dëmtojn mjedisin me seriozitet ose potencialisht.⁹⁶

Si veprojnë ligjet për patentat në Evropë me çështjen e zvogëlimit tëCO2?

Ligji për patenta është shumë i ngjajshem në mbarë Evropën pasi që të gjitha shtetet Evropiane janë palë në Konventen evropiane të patentave, e cilla parashikon rregulla të përbashkëta.Pikëpamja e tanishme e KPE është se ajo vetë do të vlersoj se një shpikje në të vërtetë dëmton mjedisin apo jo. Për disa shpikje do të kërkohet testim, ashtu sic kishte bërë KPE test me një mij, ku rezultatet ishin se dëmi i pësuar miut ishte më i madh se përfitimi nga shpikja, andaj KPE refuzoi aplikimin e patentës. Për tu revokuar shpikja duhet të egzistoj kërcenim i mjaftueshëm ndaj mjedisit.Mbi të gjitha duhet cekur se është e pamundur të bëhet një shpikje apo zbulim apo krijim që nuk do të lëshojë aspak CO2. ⁹⁷

2.5.2 E drejta e autorit (copyright) dhe të drejtat përkatëse

E drejta e autorit dhe të drejtat përkatëse paraqiten të jenë krijimtari intelektuale e autorit e cila krijohet në lëminë e letërsisë, shkencës dhe artit. E drejta e autorit konsiderohet të jetë e drejtë e cila mbron autorin gjatë krijimit të veprës së tij intelektuale. Si vepra të autorit konsiderohen: veprat letrare, punimet shkencore, veprat dramatike dhe muzikore, veprat kareografike, veprat fotografike, veprat artistike, veprat arkitektonike, veprat kinematografike, programet kompjuterike etj.

Të drejtat e autorit ndahen në të drejta personale të cilat lidhen me personalitetin e autorit dhe të drejta materiale që mbrojnë interesat pasurore të autorit.Autori ka të drejtë ekskluzive mbi veprën e tij, ka të drejtën e rishitjes, huazimit publik, të drejtë për kompenzim të vecant.Mirëpo

⁹⁵ Article 27.1. of the TRIPs Agreement.

⁹⁶ TRIPs, supra note 23, art. 27.

⁹⁷ See generally Convention on the Grant of European Patents, Oct. 5, 1973, available at http://www.wipo.int/clea/docs_new/pdf/en/ep/ep001en.pdf (last visited Jan. 17, 2008) [hereinafter EPC]

vepra nuk mund të jetë publikim imoral, fyes apo vepër që ka pasojë apo ndikim negativ në mjedisin tonë.

Ne Konventën e Bernës nuk ka ndonjë dispozitë specifike që mohon mbrojtjen e të drejtave të autorit nëse vepra dëmton mjedisin ose, konkretisht, rrit nivelet e CO2 në atmosferë. Një instrument më i rri ndërkombëtar të të drejtave të autorit, TRIP si dhe Traktatet e Oganizatës Botërore së Pronës intelektuale, potencon se autori i një vepre qe rrit nivelin e CO2 nuk mund të fitojë mbrojtje autoriale.

Direktivat Evropiane në fushën e të drejtës së autorit nuk e adresojnë këtëproblem. Por në Mbretërinë e Bashkuar, gjykatat zhvilluan nocion ku potencojnë se titullaret veprat e të cilat janë: “të pavëmendshme, imorale, shpifëse, jofetare ose mashtruese ndaj publikut” refuzohen të fitojnë të drejtë autori. Për sa i përket punimeve arkitekturore, edhe atyre autoriteteve të planeve arkitekturore nuk u jepet mbrojtja për ndërtesat që lëshojnë CO2. Kjo do ti nxit arkitektet që të hartojnë ndërtesa neutrale të karbonit. Pasi planet arkitekturore që nuk jan miqësore për mjedisin nuk do të mbrohen, andaj edhe arkitektët do të jenë më pak të tërhequr për ti hartuar.⁹⁸

2.5.3 Markat tregtare (trademarks)

Marka tregtare është lloj i pronës intelektuale që përbehet nga një shenjë, model, simbol, shprehje, vizatima, shifër apo kombinim i këtyre elementve që identifikon një produkt, organizacion, kompani ose entitet guvernativ. Qëllimi i markës tregtare është identifikimi i produktit në mënyrë të vecantë, që të mund të dallohen nga klientet produktet e ndryshme. Me markë tregtare bëhet mbrojtja juridike e shenjave me të cilat bëhet qarkullimi tregtar. Që të mund të fitohet mbrojtja juridike e një shenje si markë duhet të plotësohen disa kushte⁹⁹:

1. Distinktiviteti i shenjës
2. Lidhshmëria për mall apo shërbim të caktuar
3. Lidhshmëria për ushtrimin e veprimtarisë së caktuar ekonomike
4. Përdorimi i shenjës në qarkullimin ekonomik

Disa shenja vecohen se nuk kanë të drejtë të mbrohen me markë, edhe atë:

1. Shenjë që është në kundërshtim me ligjin dhe moralin shoqërorë
2. Nuk është distinktive
3. Tregon llojin e malit apo shërbimit, qëllimine tye apo kohën dhe mënyrën e prodhimit, kualitetin, cmimin ,sasinë e kështu me rradhë

⁹⁸ Understanding Copyright and Related Rights / World Intellectual Property Organization 34, chemin des Colombettes P.O. Box 18 CH-1211 Geneva 20

⁹⁹ E drejta e Pronësisë Intelektuale / Adnan Jashari / fq. 20

4. Me pamjen dhe përmbajtjen e saj mund të krijojë lajthim.

Bartësi i markës tregtare ka të drejtë ekzuzive për shfrytëzim të markes, deri ne 10 vite.¹⁰⁰

Egzistojnë Marka tregtare të Gjelbërta të cilat adulojnë të jenë miqësore për mjedisin, andaj edhe për këto marka përdoren shenja: jeshile, gjelbërim, natyrë, shenja të pastra të tjera me ngjyrë jeshile apo kaltër.

Shumë marka tregtare të gjelbëra po regjistrohen në treg, andaj bëhet e vështirë për të gjetur një markë distinktive dhe të vecantë, si dhe kjo mund të shkaktojë lajthim pasi egzistojnë shumë marka tregtare të ngjajshme që dallohen shumë rëndë. Andaj me qëllim që të mund të vim deri te një markë tregtare të gjelbërt, duhet ti shmangemi termave të tepruar të ketij lloji të markës tregtare si p.sh: jeshilja, natyrat e kështu me rradhë, të sigurohemi që jemi 100% të sinqertë në pretendimet tona, me qëllim që të mos paraqesim sjellje mashtruese në treg dhe të gjobitemi për të njejtën.¹⁰¹

2.5.4 Dizajni industrial

Sipas Nenit 127 të Ligjit të pronësisë intelektuale në RMV Me të drejtën e dizajnit industrial, mbrohet dizajni i cili është i ri dhe ka karakter individual. Dizajni industrial është pamja e jashtme e produktit në tërësi ose e pjesës së tij, e cila është përcaktuar nga veçoritë e tij, veçanërisht linjat, tiparet, konturat, ngjyrat, forma, tekstura dhe matricat nga të cilat përbëhet ose zbukurohet produkti si dhe/ose ornamentet.¹⁰²

Në një kuptim juridik, një dizajn industrial përbën aspektin zbukurues të një artikulli. Dizajni industrial duhet të jetë unik dhe i ri për të fituar të drejtën. Dizajni llogaritet për identik edhe atëherë kur dallohet në pjesët e parëndësishme. Pronari i një dizajni industrial të regjistruar ka të drejtë të parandalojë palët e treta nga bërja, shitja ose ompirtimi i artikujve që përmbajnë një model që është kopje e modelit të mbrojtur. Për të fituar të drejtën e mbrojtjes ligjore, dizajni industrial duhet të regjistrohet. Në disa vende, dizajnet industrial mbrohen nën ligjin e patentave si “patentat e modelit(dizajnit)”, ndërsa në disa vende të tjera për kohë të kufizuar ua japin dizajnet industrial pa regjistrim të ashtuquajtura “dizajne industrial të paregjistruara”. Nga ana tjetër, meqenëse të mirat intelektuale mund t'i perceptojmë vetëm nëse ato përfshihen në gjëra fizike, idetë jo-materiale nuk mund të mbrohen¹⁰³

Dizajni duhet të jetë i përshtatshëm për të fituar mbrojtjen ligjore apo të ketë vecori të jashtëzakonshme, ose ato lloj dizajnesh pritet të bëhen ikona afatgjata. Shumë dizajne, që mos mund të falsifikohen, shpesh janë edhe të mbrojtura me ligjin e markës tregtare.

¹⁰⁰ E drejta e Pronësisë Intelektuale / Adnan Jashari / fq. 20

¹⁰¹ Find Law / Learn About the Law / Types of Trade Marks / [Types of Trademarks - FindLaw](#)

¹⁰² LIGJ PËR PRONËSINË INDUSTRIALE - PJESA E TRETË DIZAJNI INDUSTRIAL Lënda e mbrojtjes - NENI 27 Paragrafi 1 dhe 2

¹⁰³ Wipo World Intellectual Property Organization / About IP / Industrial Designs

Me të drejtë të dizajnit industrial, nuk mund të mbrohet dizajni i cili:

1. është në kundërshtim me rendin publik ose moralin;
2. paraqet plan ose skicë teknike;
3. paraqet vepër ekskluzive kartografike ose fotografike;
4. përmban stemë shtetërore ose stemë tjetër publike , flamur ose amblemë, emër ose shkurtesë të emrit të ndonjë organizate ndërkombëtare, përveç me leje nga organi kompetent shtetit ose organizatës përkatëse;
5. i cili përmbanë ose imiton personalitet ose emër të personit të njohur ose të vdekur historik të Republikës së Maqedonisë, përveç me leje të organit kompetent të administratës shtetërore ;
6. i cili përmbanë ose imiton emër, formë ose pjesë tjetër njohëse, të trashigimisë së mbrojtur kulturore të Republikës së Maqedonisë, përveç me leje të organit kompetent të administratës shtetërore.¹⁰⁴

2.5.5 Sekretet tregtare

Sekretet tregtare janë pjesë e të drejtës së pronësisë Intelektuale që përmbajnë formula, praktika, procese, skema, instrumente, modele ose përpilime të informacionit, me vlerë komerciale sepse janë sekrete, nuk janë të njohura përgjithsisht nga publiku, të cilat pronari (mbajtësi) i këtyre të drejtave i mban të fshehta nën justifikime të arsyeshme. Blerja, përdorimi ose zbulimi i paautorizuar i një informacioni të tillë sekret në një mënyrë në kundërshtim me praktikën e ndershme tregtare nga të tjerët konsiderohet si një praktikë e padrejtë dhe shkelje e mbrojtjes së sekretit tregtar.

Në përgjithësi, çdo informacion konfidencial i biznesit që i jep një ndërmarrje një avantazh konkurrues dhe është i panjohur për të tjerët mund të mbrohet si një sekret tregtar. Shembuj të informacionit që mund të mbrohen nga sekretet tregtare përfshijnë informacionet financiare, formula, receta dhe kodet burimore. Mbrojtja ligjore e sekreteve tregtare bën pjesë në konceptin e përgjithshëm të mbrojtjes nga konkurrenca e pandershme ose bazohet në dispozita specifike ose praktikë gjyqësore për mbrojtjen e informacionit konfidencial.¹⁰⁵

¹⁰⁴ PJESA E TRETË DIZAJNI INDUSTRIAL Lënda e mbrojtjes / Dizajni i kushtëzuar nga funksionet teknike dhe dizajni i elementeve të lidhura / fq.45

¹⁰⁵ WIPO / WORLD INTELLECTUAL PROPERTY ORGANIZATION / TRADE SECRETS / [Trade Secrets \(wipo.int\)](http://wipo.int)

Kapitulli i III

Mekanizmat ndërkombëtarë që rregullojnë përdorimin e pronësisë intelektuale në çështjet që lidhen me ndryshimet klimatike

3.1 Organizata botërore për pronësi intelektuale, WIPO GREEN

Organizata botërore për pronësi intelektuale WIPO GREEN është një nga 15 agjencitë e specializuara të Kombeve të Bashkuara¹⁰⁶. WIPO u krijua për të promovuar dhe mbrojtur pronësinë intelektuale (IP) në të gjithë botën duke bashkëpunuar me vendet si dhe organizatat ndërkombëtare. WIPO GREEN u themelua në vitin 2013 nga Organizata Botërore e Pronësisë Intelektuale. Selia e WIPO gjendet në Gjenevë, Zvicër, mirëpo ka "zyra të jashtme" në të gjithë botën, përfshirë në Algjer, Algjeri; Rio de Janeiro, Brazil; Pekin, Kinë, Tokio, Japoni; Moskë, Rusi; dhe Singapori. Aktualisht ka 193 shtete anëtare. WIPO GREEN është një platformë online për shkëmbimin e teknologjisë. Një ndër vlerat thelbësore të WIPO është përgjegjësia mjedisore.¹⁰⁷

Organizata Botërore e Pronësisë Intelektuale (WIPO) është e përkushtuar në zhvillimin e një sistemi të ekuilibruar dhe të arritshëm të pronës intelektuale ndërkombëtare (IP) që shpërblen kreativitetin, stimulon inovacionin dhe kontribuon në zhvillimin ekonomik duke ruajtur interesin publik.¹⁰⁸ Synimi i saj është të mbrojë pronësinë Intelektuale përmes bashkëpunimit midis shteteve dhe organizatave të tjera ndërkombëtar, të zgjedh mosmarrëveshjet e PI jashtë gjykatave dhe ka për qëllim ti bashkoj lojtarët kryesorë për të katalizuar inovacionin dhe përhapjen e teknologjisë së gjelbër. WIPO administron 24 traktate që kanë të bëjnë me aspekte të ndryshme ligjore dhe administrative të pronës intelektuale, veçanërisht Konventa e Parisit për Mbrojtjen e Pronës Industriale (173 palë kontraktuese që nga qershori 2011), Konventa e Bernës për Mbrojtjen e Veprave Letrare dhe Artistike (164 kontraktime palët) dhe Traktati i Bashkëpunimit për Patentat (143 palë kontraktuese).¹⁰⁹

Struktura e WIPO përbëhet nga disa organe edhe atë:

- Asambleja e Përgjithshme
- Konferenca
- Komiteti I Koordinimit
- Sekretariati

¹⁰⁶ *"REPERTORY OF PRACTICE OF UNITED NATIONS ORGANS SUPPLEMENT No. 10 (2000-2009) - ARTICLE 17(3)" (PDF)*. United Nations. Archived from *the original* (PDF) on 19 October 2013. Retrieved 18 September 2013. The number of specialized agencies thus rose to fifteen.

¹⁰⁷ *"Convention Establishing the World Intellectual Property Organization signed at Stockholm on 14 July 1967. Preamble, second paragraph"*. Wipo.int.

¹⁰⁸ United Nations System – Chief Executives Board for Coordination – World Intellectual Property Organization

¹⁰⁹ United Nations System – Chief Executives Board for Coordination – World Intellectual Property Organization

Asambleja e Përgjithshme është organi më i lartë vendimmarrës i Organizatës dhe ka 176 anëtarë. Konferenca ka 184 anëtarë.

WIPO GREEN është formuar dhe egziston për të ndihmuar dhe rritur njohuritë dhe qasjen në teknologjitë egzistuese të cilat paraqiten të jenë miqësore ndaj mjedisit dhe gjen zgjedhje në lidhje me problematiken e ndryshimit të klimës. “Teknologjitë e gjelbërta” janë teknologji të shëndosha për mjedisin siç përcaktohet në Kapitullin 34 të Agjendës 21 (Programi i Veprimit i Kombeve të Bashkuara nga Rio, 1992). Teknologjitë e gjelbra "mbrojnë mjedisin, janë më pak ndotës, përdorin të gjitha burimet në një mënyrë më të qëndrueshme dhe riciklojnë më shumë mbeturina”.

WIPO GREEN u nis në 2013 në një përpjekje për të katalizuar dhe përshpejtuar inovacionin e teknologjisë së gjelbër dhe transferimin e saj për të zgjeruar marrjen dhe përdorimin e teknologjive miqësore me mjedisin në mbështetje të tranzicionit në një të ardhme me karbon të ulët.

Përpjekje të mëdha janë prodhuar në:

- Reduktimi i emetimeve dhe ndikimeve nga ndërtesat dhe udhëtimet e WIPO;
- Përdorimi i drurit lokal si material ndërtimi dhe zbatimi i kulmeve të gjelbërta në dy ndërtesa (1800 m² çati e gjelbër me një përzjerje të bimëve lokale që rrit; biodiversitetin. Nuk ka nevojë për ujitje, pesticide ose insekticide);
- Ndërgjegjësimi i stafit për lëvizshmërinë e butë.¹¹⁰

WIPO inkurajon lëvizjen e butë për punonjësit që udhëtojnë përmes disa stimuljeve të përsëritur, dmth:

- Që nga viti 2013, WIPO zbaton dy herë në vit një stendë për riparimin e biçikletave për biçikletat personale të punonjësve: më shumë se 100 biçikleta kontrollohen dhe riparohen çdo vit;
- 5 biçikleta elektronike të blera nga WIPO janë në dispozicion për të gjithë punonjësit për udhëtimet e tyre lokale të biznesit ose gjatë kohës së drekës;
- Që nga viti 2013, kartat e transportit Publik të parapaguar u ofrohen punonjësve dy herë në vit për të inkurajuar përdorimin e transportit public.¹¹¹

Qasja e qëndrueshme në ujë ose klimë si dhe menaxhimi miqësor i kanalizimeve e bën kryesisht përmes bazës së të dhënave WIPO GREEN, e cila aktualisht përmban më shumë se 3,000 teknologji dhe ndihma.

Baza e të dhënave WIPO GREEN është shtylla kurrizore e platformës WIPO GREEN, e cilave përfshin shtatë kategori të teknologjisë:

- Ndërtimi;

¹¹⁰ Greening The blue – World Intellectual Property Organization (WIPO)

¹¹¹¹¹¹ Greening The blue – World Intellectual Property Organization (WIPO)

- Energjia;
- Bujqësia dhe Pylltaria;
- Ndotja dhe mbeturinat;
- Transporti;
- Uji; dhe
- Produktet, materialet dhe proceset.

Secila kategori përfshin një seri të nënkategorive përkatëse. Për shembull, nënkategoritë për Ndotjen dhe Mbeturinat përfshijnë riciklimin, menaxhimin e mbeturinave, ndotjen e ajrit, etj. Wipo Green është një platformë pa pagesë nën shërbimin e gjithë atyre që kanë nevojë, të cilët i adresohen WIPO GREEN për ndonjë zgjidhje specifike në lidhje me klimën. Platforma u shërben gati 1.500 përdoruesve ndërkombëtarë nga 63 vende, përfshirë ndërmarrjet e vogla dhe të mesme, universitetet dhe institucionet kërkimore, si dhe ndërmarrjet shumëkombëshe

Plani Strategjik WIPO GREEN për periudhën 2019 deri në 2023, e çon programin në një nivel të ri. Ky plan ambicioz identifikon tre qëllime kyçe. Mbështetjen e vendeve anëtare për të shfrytëzuar Pronësinë Intelektuale dhe inovacionin për të zgjedhur problemet në lidhje me ndryshimin e klimës, siç janë ushqimore dhe mjedisin. Kjo qasje e gjerë ndaj zhvillimit bujqësor kërkon të rrisë produktivitetin bujqësor, të përmirësojë qëndrueshmërinë dhe të zvogëlojë cenueshmërinë ndaj ndryshimeve klimatike dhe të ulë emetimet e gazeve serë.

Inovacioni ka një rol qendror për të luajtur në trajtimin e ndryshimit të klimës, siç pohohet në Marrëveshjen e Parisit për Ndryshimin e Klimës (neni 10), i cili thotë, "[një] përsheptimi, inkurajimi dhe mundësimi i inovacionit është thelbësorë për një përgjigje globale efektive, afatgjatë ndaj ndryshimeve klimatike dhe promovimit të rritjes ekonomike dhe zhvillimit të qëndrueshëm."¹¹²

Sistemi PI nxit inovacionin, si dhe transferimin dhe shpërndarjen e teknologjisë - përfshirë teknologjinë miqësore me klimën. Ndërsa të drejtat e IP sigurojnë stimuj ekonomikë për të zhvilluar zgjidhje të reja, ato gjithashtu mund të ndihmojnë në shpërndarjen e inovacionit në vendet me nevojë më të madhe, përmes për shembull, marrëveshjeve të licencimit, ndërmarrjeve të përbashkëta dhe më shumë.

Që nga fillimi i tij në 2013, WIPO GREEN ka krijuar një rrjet të gjerë të aktorëve ndërkombëtarë të angazhuar në zbutjen dhe adaptimin e ndryshimeve klimatike. Ky grup ndër-sektorial i partnerëve aktualisht përfshin mbi 100 organizata ndërkombëtare, zyra IP, shoqata tregtare dhe biznesi, korporata shumëkombëshe, qeveri dhe institucione financuese, universitete dhe qendra kërkimore. Secili partner luan një rol të ndryshëm në përputhje me ekspertizën e tij të veçantë. Për shembull, "partnerët e bazës së të dhënave" shtojnë teknologji në bazën e të dhënave. WIPO GREEN gjithashtu ka krijuar partneritete rreth politikës, kërkimit dhe komunikimit, asistencës

¹¹² PARIS AGREEMENT

https://unfccc.int/files/essential_background/convention/application/pdf/english_paris_agreement.pdf

teknike dhe financave. Secili lloj partneriteti jep një kontribut të rëndësishëm në misionin e WIPO GREEN për të përshpejtuar tranzicionin në një ekonomi globale më të gjelbër.¹¹³

RAST:

Kanë ndodhur bashkëpunime të ndryshme të reja midis ofruesve të teknologjisë dhe kërkuesve, të cilat demonstronë ndikimin pozitiv të projekteve të përshpejtimit të WIPO GREEN. Për shembull, në vitin 2018, përmes projektit të përshpejtimit WIPO GREEN të Azisë Juglindore, Shkolla e Gjelbër në Bali, Indonezi, e lidhur me Ujin Zero Mass (SHBA). Kjo rezultoi në një bashkëpunim që lejoi kampusin Bali të shkollës të përdorte SOURCE Hydropanel të Zero Mass Water (Misioni i Zero Mass Water është që ta bëjë ujin e pijshëm një burim të pakufizuar. SOURCE është një Hydropanel që krijon ujë të pijshëm thjesht nga rrezet e diellit dhe ajri - i mundësuar nga kombinimi i termodinamikës, shkencës së materialeve dhe teknologjisë së kontrolleve) për t'u siguruar studentëve të saj një furnizim të rregullt me ujë të pijshëm të pastër.

Qëllimi i Shkollës së gjelbër është të krijojë një mjedis të qëndrueshëm arsimor. Shkolla ka përfshirë teknologji të ndryshme të pastra në operacionet e saj të përditshme, duke përfshirë burimet e ripërtëritshme të energjisë, e cila furnizon 85 për qind të nevojave të shkollës për energji, një sistem filtrimi të ujit, një qendër të menaxhimit të mbeturinave, një stacion kompostimi, akuaponikë dhe autobusë me bionaftë.

Në vitin 2018, Green School's Innovation Hub po kërkonte për një mënyrë të lehtë për tu mirëmbajtur për të gjeneruar ujë të pijshëm për kampusin, veçanërisht në sezonin e thatë. Në qershor të atij viti, stafi nga shkolla mori pjesë në Ngjarjen e Teknologjisë së Gjelbër të WIPO GREEN në Matchmaking - pjesë e projektit të përshpejtimit të Azisë Juglindore - ku ata takuan Zero Mass Water, i cili përdor energjinë diellore për të nxjerrë lagështi nga ajri për të prodhuar ujë të pijshëm.

E gjithë pasuarit e WIPO GREEN – baza e të dhënave, rrjeti dhe projektet – janë mjete praktike që na për të luftuar ndryshimet klimatike dhe na shërbejnë për një botë më të gjelbert. Për WIPO dhe ekipin WIPO GREEN, dhënia e një kontributi praktik dhe veprues në sfidat e panumërta mjedisore me të cilat përballet bota sot është qëllimi dhe detyra e tyre.¹¹⁴

3.2 Organizata botërore e tregëtisë (WTO): Marrëveshja për aspektet tregtare të pronësisë intelektuale (TRIPS)

¹¹³ WIPO MAGAZINE / WIPO GREEN – Supporting green innovation and technology transfer / 1/2020

¹¹⁴ WIPO MAGAZINE / WIPO GREEN – Supporting green innovation and technology transfer / 1/2020

Marrëveshja mbi aspektet e lidhura me tregtinë e të drejtave të pronësisë intelektuale TRIPS është marrëveshje shumëpalëshe nën Orgaizatën Botërore të Tregtisë (OBT) që hyri në fuqi në 1996, e krijuar për të trajtuar të drejtat e Pronës Intelektuale (PI), vecanërisht të drejtat e autorit dhe patentat. Është një marrëveshje ligjore ndërkombëtare midis të gjitha kombeve anëtare të Organizatës Botërore të Tregtisë (OBT) dhe administohet nga OBT. Marrëveshja TRIPS prezantoi ligjin e pronësisë intelektuale në sistemin tregtar shumëpalësh për herë të parë dhe mbetet marrëveshja më gjithëpërfshirëse shumëpalëshe mbi pronën intelektuale deri më tani.¹¹⁵

Tri tiparet kryesore të Marrëveshjes janë: **Standardet, zbatimi dhe zgjidhja e mosmarrëveshjeve.**

Standardet- Marrëveshja përcakton standardet minimale të mbrojtjes që duhet të sigurohen nga secili anëtar. Lënda që duhet mbrohet, i përcaktohet secili element kryesorë, kohëzgjatja e mbrojtjes dhe të dejtat dhe përjashtimet e lejueshme nga ato të drejta. Marrëveshja i përcakton këto standarde, duke kërkuar respektimin Konventes kryesore të WIPO, Konventa e Parisit Për mbrojtjen e pronës industriale dhe Konventa e Bernës për mbrojtjen e veprave letrare dhe artistike. Kjo mund të shihet në nenet 2.1 dhe 9.1 të Marrëveshjes TRIPS:¹¹⁶

Zbatimi – bën pjesë në grupin e dytë kryesor të dispozitave që ka të bëjë me procedurat e brendshme dhe mjetet juridike për zbatimin e të drejtave të PI, dispozita mbi procedurat civile, administrative dhe procedura penale, masa të përkohshme dhe mjete juridike të cilat i zbatojnë mbajtësit e të drejtave në mënyre efektive dhe ti kenë mire në dispozicion.

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve - procedurat e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve.

Qëllimet e përgjithshme të Marrëveshjes TRIPS përmbahen në Preambulën e marrëveshjes. Këto objektiva përfshijnë zvogëlimin e shtrembërimeve dhe pengesave në tregtinë ndërkombëtare, promovimin e mbrojtjes efektive dhe adekuate të të drejtave të pronësisë intelektuale dhe sigurimin që masat dhe procedurat për të zbatuar të drejtat e pronësisë intelektuale nuk bëhen vetë pengesa për tregtinë e ligjshme. Për sa i përket temës së ndryshimeve klimatike, anëtarët e OBT-së gjithashtu e kanë trajtuar këtë temë në takimet e Këshillit TRIPS.

Marrëveshja TRIPS është pjesë e sistemit global të pronës intelektuale që synon të kontribuojë në promovimin e inovacionit teknologjik dhe transferimin dhe shpërndarjen e saj. Disa delegacione të vendeve në zhvillim që negociojnë çështje të ndryshimit të klimës kanë argumentuar se "fleksibilitetet" në Marrëveshjen TRIPS janë të rëndësishme për qasjen në teknologjinë e gjelbër. Këto fleksibilitete janë në dispozita të ndryshme që lejojnë qeveritë të lehtësojnë disa detyrime themelore të mbrojtjes së pronës intelektuale, siç janë të drejtat e

¹¹⁵ https://en.wikipedia.org/wiki/TRIPS_Agreement

¹¹⁶ 1. Në lidhje me Pjesët II, III dhe IV të kësaj Marrëveshjeje, Anëtarët do të veprojnë në përputhje me nenet 1 deri në 12 dhe nenin 19, të Konventës së Parisit (1967).

Asgjë në Pjesët I deri IV të kësaj Marrëveshjeje nuk do të përjashtojë nga detyrimet ekzistuese që Anëtarët mund të kenë ndaj njëri-tjetrit në bazë të Konventës së Parisit, Konventës së Bernës, Konventës së Romës dhe Traktatit të Pronës Intelektuale në lidhje me Qarqet e Integruara

patentës, në kushte të caktuara. (Një nga fleksibilitetet më të debatuarra gjerësisht është "licencimi i detyrueshëm" për farmaceutikën,)¹¹⁷

Në preambulën e Marrëveshjes mbi Aspektet e Tregtisë të Drejtave të Pronës Intelektuale, Anëtarët i referohen dy herë promovimit të transferimit të teknologjisë në vendet në zhvillim. Për më tepër, dispozitat mbi objektivat themelore dhe parimet të Marrëveshjes TRIPS njohin nevojën për zhvillimin dhe transferimin e teknologjisë në mënyrë që të krijohen baza të shëndosha dhe të qëndrueshme teknologjike për mbrojtjen e shëndetit publik dhe të ushqyerit dhe për të promovuar interesin publik në sektorë me rëndësi jetike në zhvillimin e tyre socio-ekonomik dhe teknologjik.

Për të luftuar ndryshimet klimatike, çështja kryesore është transferimi i teknologjisë për të zbutur efektet e gazrave serë. Prandaj, sa më shpejtë të ndërmerren masat adekuate, aq më pak pasoja do rezultojnë. Për vendet në zhvillim, bashkpunimi teknologjik me të drejtat e pronësisë intelektuale paraqitet një mekanizëm i forte për ti luftuar ndryshimet klimatike. Analizat e shumta na bëjnë me dije se mungesa e informacionit dhe mbrojtja e tepruar, dhe zbatimi i papërshtatshëm dhe abuzimi i të drejtave të pronësisë intelektuale, dhe veçanërisht i patentave, pa nxitjen efektive të mirëqenies sociale dhe ekonomike përbëjnë një lloj pengese në mjedis.

Aplikimet teknologjike dhe mbrojtja e të drejtave të PI janë opsionet më të rëndësishme në lidhje me ndryshimin e klimës. Për të mbrojtur të drejtat e pronësisë intelektuale duhet të përqëndrohemi në transferimin e teknologjisë. Marrëveshja TRIPS synon të arrijë transferimin dhe shpërndarjen e teknologjisë në vendet në zhvillim, ndërsa nga anëtarët e vendeve të zhvilluara kërkon të sigurojnë stimuj për kompanitë e tyre për të promovuar transferimin e teknologjisë në vendet më pak të zhvilluara.

Neni 7 ("Objektivat") e Marrëveshjes TRIPS thotë se mbrojtja dhe zbatimi i të drejtave të pronësisë intelektuale duhet të kontribuojë në promovimin e inovacionit teknologjik dhe në transferimin dhe shpërndarjen e teknologjisë, në avantazhin e ndërsjellë të prodhuesve dhe përdoruesve të njohurive teknologjike dhe në një mënyrë të favorshme për mirëqenien sociale dhe ekonomike dhe për një ekuilibër të të drejtave dhe detyrimeve.

Nenet 7 dhe 8 janë artikuj të rëndësishëm që ofrojnë interpretim të marrëveshjes TRIP në tërësi. Sipas nenit 7, Te drejtat e pronësisë intelektuale të duhet të punojë "në një mënyrë të favorshme për mirëqenien sociale dhe ekonomike" dhe kërkojnë një ekuilibër midis të drejtave dhe detyrimeve të pronarëve të të drejtave të pronësisë intelektuale. Sidoqoftë, marrëveshja nuk jep ndonjë standard për ta bërë këtë ekuilibër. Nga ana tjetër, pjesa e parë e nenit 7 "do të thotë që njohja dhe zbatimi i të drejtave të pronësisë intelektuale janë subjekt te vlerat më të larta shoqërore".

Në çdo rast, një numër vendesh në zhvillim, konfirmojnë rëndësinë e nenit 7 dhe 8 në interpretimin e TRIPs.

¹¹⁷ World Trade Organization – Climate change and Trips

1. Anëtarët, në formulimin ose ndryshimin e ligjeve dhe rregulloreve të tyre, mund të miratojnë masat e nevojshme për të mbrojtur shëndetin publik dhe ushqimin, dhe për të promovuar interesin publik në sektorë me rëndësi jetike për zhvillimin e tyre socio-ekonomik dhe teknologjik, me kusht që masa të tilla të jenë të qëndrueshme me dispozitat e kësaj Marrëveshjeje.

2. Masat e duhura, me kusht që ato të jenë në përputhje me dispozitat e kësaj Marrëveshjeje, mund të jenë të nevojshme për të parandaluar abuzimin e të drejtave të pronësisë intelektuale nga mbajtësit e të drejtave ose përdorimin e praktikave që ndalojnë pa arsye tregtinë ose ndikojnë negativisht në transferimin ndërkombëtar të teknologjisë.

3.3 Konferenca e Kombeve të bashkuara për mjedisin jetësor dhe zhvillimin ("EarthSummit"), në Rio De Zhaniero, 1992

Ka pasur lëvizje drejt një konsensusi ndërkombëtar në lidhje me përgjigjet ndaj ndryshimit të klimës. Një moment kyç ishte Konferenca e Kombeve të Bashkuara për mjedisin dhe zhvillim ("Samiti i Tokës") në Rio de Janeiro në 1992 ku morën pjesë 172 qeveri, OJQ-të dhe individët. Samiti i Tokës nuk ishte konferenca e parë ndërkombëtare për të adresuar çështje mjedisore. Në vitin 1972 Kombet e Bashkuara mbledhën Konferencën e Kombeve të Bashkuara mbi Mjedisin Njerëzor në Stokholm, Suedi. Kjo konferencë, e quajtur shpesh Konferenca e Stokholmit, ishte konferenca e parë ndërkombëtare për të adresuar drejtpërdrejt problemet mjedisore.

Për sa i përket konferencës Samiti i Tokës, ishte konferenca më e madhe e KB e mbajtur në Rio de Zhaniero më 3 Janar – 14 Qershor 1992, e cila ka tërhequr mbi 30,000 njerëz, përfshirë më shumë se 100 kryetarë shtetesh. (burimi/fusnota)

Rezultati i Samiti rezultuan që vendet pjesëmarrëse të nënshkruan tre marrëveshje, jo të detyrueshme në të drejtën ndërkombëtare: **Agjenda 21, Deklarata e Rios, Deklarata e Parimeve të Pyjeve** dhe tre konventa ligjrisht të detyrueshme **Konventa Kuadër për Ndryshimin e Klimës (UNFCCC), Konventa për Diversitetin Biologjik dhe Konventa për të Luftuar Shkretëtirëzimin (UNCCD).**

- **Konventa kuadër për ndryshimin e klimës (UNFCCC)** synon të stabilizojë nivelet e emetimeve të gazrave serë që ngrohin atmosferën, dhe të cilat mund të kenë një ndikim negativ në mjedis.
- **Konventa mbi diversitetin biologjik** ishte traktati i parë ndërkombëtar që adresoi ruajtjen e larmisë biologjike. 196 Kombe e kanë nënshkruar Konventën për Diversitetin Biologjik.

Konventa ka tre qëllime kryesore: ruajtjen e larmisë biologjike (ose biodiversitetit); përdorimi i qëndrueshëm i përbërësve të tij; dhe ndarja e drejtë dhe e drejtë e përfitimeve që vijnë nga burimet gjenetike. Ruajtja e biodiversitetit është një shqetësim i përbashkët i njerëzimit. Konventa për Diversitetin biologjik përfshin biodiversitetin në të gjitha nivelet: ekosistemet, speciet dhe burimet gjenetike. Ai gjithashtu mbulon bioteknologjinë, përfshirë përmes Protokollit të Kartagjenës për Biosigurinë. Në fakt, ai mbulon të gjitha fushat e mundshme që kanë të bëjnë drejtpërdrejt ose indirekt me biodiversitetin dhe rolin e tij në zhvillim, duke filluar nga shkenca, politika dhe arsimiti te bujqësia, biznesi, kultura dhe më tepër.¹¹⁸

- **Konventa për të luftuar shkretëtirëzimin (UNCCD)** - është një Konventë për të luftuar shkretëtirëzimin dhe për të zbutur efektet e thatësirës përmes programeve kombëtare të veprimit që përfshijnë strategji afatgjata të mbështetura nga bashkëpunimi ndërkombëtar dhe marrëveshjet e partneritetit.
- **Delkarata e parimeve të pyjeve** - është një dokument jo-ligjërishit i detyrueshëm që bën disa rekomandime për ruajtjen dhe zhvillimin e qëndrueshëm të pyjeve.
- **Agenda 21** është një plan veprimi global për Shekullin 21. Dokument me 351 faqe dhe e ndarë në katër seksione:

Seksioni I: Dimensionet sociale dhe ekonomike drejtohet drejt luftimit të varfërisë, veçanërisht në vendet në zhvillim, ndryshimit të modeleve të konsumit, promovimit të shëndetit, arritjes së një popullsie më të qëndrueshme dhe vendosjes së qëndrueshme në vendimmarrje.

Seksioni II: Ruajtja dhe menaxhimi i burimeve për zhvillim përfshin mbrojtjen e atmosferës, luftimin e shpyllëzimeve, mbrojtjen e mjedisëve të brishta, ruajtjen e larmisë biologjike (biodiversitetin), kontrollin e ndotjes dhe menaxhimin e bioteknologjisë dhe mbetjeve radioaktive.

Seksioni III: Forcimi i rolit të grupeve kryesore përfshin rolet e fëmijëve dhe të rinjve, grave, OJQ-ve, autoriteteve lokale, biznesit dhe industrisë dhe punëtorëve; dhe forcimin e rolit të popujve indigjenë, komuniteteve të tyre dhe fermerëve.

Seksioni IV: Mjetet e zbatimit përfshijnë shkencën, transferimin e teknologjisë, arsimin, institucionet ndërkombëtare dhe mekanizmat financiarë.

¹¹⁸ United Nations / Convention on Biological diversity - Convention on Biological Diversity, key international instrument for sustainable development

- **Deklarata e Rios për mjedisin dhezhvillimin** - është një grup parimesh që njohin rëndësinë e ruajtjes së mjedisit dhe përcaktojnë udhëzimet ndërkombëtare për ta bërë këtë. Deklarata e Rio parashikon që shtetet duhet të bashkëpunojnë me qëllim që të permisojnë apo përvetsojnë të kuptuarit shkencor përmes shkëmbimit të njohurive teknologjike, përmes zhvillimit, adaptimit, shpërndarjes dhe transferimit të teknologjive. Disa nga parimet kryesore dhe më të rrëndësishme të Deklarates Rio, paraqiten të jenë Parimi i 8, 9, 10, 11, 12, 13, 14 dhe 15, edhe atë:

Parimi 8

Për të arritur një zhvillim të qëndrueshëm dhe një cilësi më të lartë të jetës për të gjithë njerëzit, Shtetet duhet të zvogëlojnë dhe eliminojnë modelet e paqëndrueshme të prodhimit dhe konsumit dhe të promovojnë politikatat e duhura demografike.

Parimi 9

Shtetet duhet të bashkëpunojnë për të forcuar ndërtimin endogjen të kapaciteteve për zhvillim të qëndrueshëm duke përmirësuar mirëkuptimin shkencor përmes shkëmbimeve të njohurive shkencore dhe teknologjike dhe duke rritur zhvillimin, adaptimin, përhapjen dhe transferimin e teknologjive, përfshirë teknologjitë e reja dhe inovative.

Parimi 10

Çështjet mjedisore trajtohen më së miri me pjesëmarrjen e të gjithë qytetarëve të interesuar, në nivelin përkatës. Në nivelin kombëtar, secili individ do të ketë aksesin e duhur në informacionin në lidhje me mjedisin që mbahet nga autoritetet publike, përfshirë informacionin mbi materialet e rrezikshme dhe aktivitetet në komunitetet e tyre, dhe mundësinë për të marrë pjesë në proceset e vendimmarrjes. Shtetet do të lehtësojnë dhe inkurajojnë ndërgjegjësimin dhe pjesëmarrjen e publikut duke e bërë informacionin gjerësisht të disponueshëm. Do të sigurohet qasje efektive në procedurat gjyqësore dhe administrative, duke përfshirë dëmshpërblimin dhe korrigjimin.

Parimi 11

Shtetet do të miratojnë legjislacion efektiv mjedisor. Standardet mjedisore, objektivat dhe përparësitë e menaxhimit duhet të pasqyrojnë kontekstin mjedisor dhe të zhvillimit për të cilin ato zbatohen. Standardet e zbatuara nga disa vende mund të jenë të papërshtatshme dhe me kosto të pajustificuar ekonomike dhe sociale për vendet e tjera, veçanërisht vendet në zhvillim.

Parimi 12

Shtetet duhet të bashkëpunojnë për të promovuar një sistem ekonomik mbështetës dhe të hapur ndërkombëtar që do të çonte në rritjen ekonomike dhe zhvillimin e qëndrueshëm në të gjitha vendet, për të adresuar më mirë problemet e degradimit të mjedisit. Masat e politikës tregtare për qëllime mjedisore nuk duhet të përbëjnë mjet diskriminimi arbitrar ose të pajustificueshëm ose një kufizim të maskuar të tregtisë ndërkombëtare. Duhet të shmangen veprimet e njëanshme për të trajtuar sfidat mjedisore jashtë juridiksionit të vendit importues. Masat mjedisore që

adresojnë problemet mjedisore ndërkufitare ose globale duhet, sa të jetë e mundur, të bazohen në një konsensus ndërkombëtar.

Parimi 13

Shtetet do të zhvillojnë ligjin kombëtar në lidhje me përgjegjësinë dhe kompensimin për viktimat e ndotjes dhe dëmtimeve të tjera mjedisore. Shtetet do të bashkëpunojnë gjithashtu në një mënyrë të shpejtë dhe më të vendosur për të zhvilluar më tej ligjin ndërkombëtar në lidhje me përgjegjësinë dhe kompensimin për efektet e dëmshme të mjedisit të shkaktuara nga aktivitetet brenda juridiksionit të tyre ose kontrollit në zonat jashtë juridiksionit të tyre.

Parimi 14

Shtetet duhet të bashkëpunojnë në mënyrë efektive për të dekurajuar ose parandaluar zhvendosjen dhe transferimin në shtetet e tjera të çdo aktiviteti dhe substancash që shkaktajnë degradim të rëndë mjedisor ose që rezultojnë të jenë të dëmshme për shëndetin e njeriut.

Parimi 15

Me qëllim të mbrojtjes së mjedisit, qasja paraprake do të zbatohet gjerësisht nga shtetet në përputhje me aftësitë e tyre. Kur ka kërcënime për dëmtime serioze ose të pakthyeshme, mungesa e sigurisë së plotë shkencore nuk do të përdoret si arsye për shtyrjen e masave me kosto efektive për të parandaluar degradimin e mjedisit.

3.4 Konventa kornizë e Kombeve tëbashkuara për ndryshimin klimatik (UNFCCC)- 1992

Maqedonia është palë e Konventës kornizë të Kombeve të bashkuar për ndryshimet klimatike (UNFCCC), ka ratifikuar Protokollin e Kiotos dhe në 2015 gjithashtu ka nënshkruar dhe ratifikuar në 2017 Marrëveshjen e Parisit. UNFCCC synon të stabilizojë nivelet e emetimeve të gazrave serë që ngrohin atmosferën, dhe të cilat mund të kenë një ndikim negativ në mjedis. UNFCCC kërkon arritjen e kësaj në një kornizë kohore e cila do t'i mundësonte ekosistemit të përshtatet natyrshëm me ndryshimet klimatike. Procedurat e mosmarrëveshjeve të UNFCCC përqëndrohen në diskutime paqësore, pajtim dhe referenca të dakorduara për arbitrazhin ose për të Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë. UNFCCC është gjithashtu një bazë për veprim të vazhdueshëm, në të gjithëkatër temat kryesore të zbutjes, adaptimit, financave dhe, më e rëndësishmja këtu, teknologjisë. Ka takime të rregullta shtetërore (Konferencat e palëve).¹¹⁹

Organizata për bashkëpunim ekonomik dhe zhvillim dhe Konferencat Kombeve të bashkuara për tregti dhe zhvillim kanë ndërmarrë disa hapa domethënës për të zvogëluar emetimet në

¹¹⁹ UNITED NATIONS FRAMEWORK CONVENTION ON CLIMATE CHANGE / UNITED NATIONS 1992 / [UNITED NATIONS FRAMEWORK CONVENTION ON CLIMATE CHANGE \(unfccc.int\)](http://unfccc.int)

aktivitetet kryesore të përdorimit të energjisë: ne energji elektrike, ngrohje dhe transport. Teknologjia luan një rol të rëndësishëm. Në Mbretërinë e Bashkuar ka egzistuar një fokus i fortë në energjinë e rinovueshme (p.sh. burime nga era, dielli). Udhëzuesi i Energjisë së Ripërtëritshme të vitit 2011 synonte të kishte 15 përqind të konsumimit të energjisë nga burimet e rinovueshme deri në vitin 2020, dhe vuri në dukje se disa teknologji ishin të afta të siguronin më shumë se 90 përqind të kësaj energjie të rinovueshme. Pavarësisht këtyre zhvillimeve, ka pyetje në lidhje me shkallën në të cilën energjia e rinovueshme mund të sigurojë sigurinë e energjisë. Buxheti në Mbretërinë e Bashkuar për vitin 2015 ndau 140 milion £ për teknologjitë inteligjente, me një fokus të veçantë në qytete.¹²⁰

Vendet e industrializuara pritej të bëjnë më shumë për të ulur emetimet, shtetet e Aneksit të cilët përfshijnë 12 vende me “ekonomi në tranzicion” nga Evropa qendrore dhe lindore. Kështu këto vende bien dakord sipas Konventës dhe duke siguruar mbështetje financiare të ndërmarrin aktivitete mbi ndryshimin e klimës. Ata gjithashtu pajtuan të ndajnë teknologjinë me kombet më pak të përparuara. Vendet e Aneksit i pritej që nga viti 2000 të ulnin emetimet në nivelet e vitit 1990. Shumë prej tyre kanë ndërmarrë veprime të forta për ta bërë këtë, dhe disa tashmë kanë pasur sukses. Vendet e industrializuara duhet të raportojnë rregullisht mbi politikën dhe masat e tyre për ndryshimin e klimës si dhe duhet të paraqesin një inventar vjetor të emisioneve të tyre të gazrave sere.

UNFCCC kërkon që vendet e zhvilluara të ndërmarrin të gjitha hapat e mundshëm për të lehtësuar, promovuar dhe transformuar teknologji të shëndosha për mjedisin, dhe njohuri teknike. UNFCCC gjithashtu kërkon që vendet të ndajnë informacion për hapat që do të marrin. Konventa parasheh një ekuilibër mes ndryshimeve klimatike dhe pëparimit ekonomik, andaj ai kërkon të zvogëlojë emetimet në mënyra që nuk do të pengojë pëparimin ekonomik. Një zgjidhje e tillë erdhi me krijimin e Protokollit të Kiotos në Konventë.

3.5 Protokoli i Kyotos, 1997

Protokolli i Kiotos u miratua në 11 Dhjetor 1997, por hyri në fuqi në 16 Shkurt 2002, dhe është ratifikuar nga 132 shtete. Protokolli i Kiotos operacionalizon Konventën kornizë të Kombeve të bashkuara për ndryshimin e klimës duke angazhuar vendet dhe ekonomitë e industrializuara në tranzicion për të kufizuar dhe zvogëluar emetimet e gazeve sere. Konventa kërkon të miratojnë politika dhe masa për zbutjen e kësaj dukurie dhe të raportojnë gjendjen në mënyrë të rregut. Protokolli i Kiotos bazohet në parimet dhe dispozitat e Konventës. Protokolli i Kiotos përcakton objektiva detyrues të zvogëlimit të emetimeve për 37 vende të industrializuara dhe ekonomi në tranzicion dhe Bashkimin Evropian. Në përgjithësi, këto synime shtojnë një ulje mesatare prej 5

¹²⁰UNITED NATIONS FRAMEWORK CONVENTION ON CLIMATE CHANGE / UNITED NATIONS 1992 / [UNITED NATIONS FRAMEWORK CONVENTION ON CLIMATE CHANGE \(unfccc.int\)](http://unfccc.int)

për qind të emisioneve krahasuar me nivelet e vitit 1990 gjatë periudhës pesë vjeçare 2008–2012.¹²¹

Qëllimi kryesor është të ulë emetimet: Dioksid karbonit (CO₂); metanit (CH₄); oksid azotit (N₂O); hidrofluorokarbureve (HFC); perfluorokarbureve (PFC); dhe heksafluorid squfurit (SF₆).

Synimet kombëtare shkojnë nga:

- EU-15% ulje: Austria, Belgjika, Bullgaria, Republika Çeke, Danimarka, Estonia, Komuniteti Evropian, Finlanda, Franca, Gjermania, Greqia, Irlanda, Italia, Letonia, Lihtenshtajni, Lituania, Luksemburgu, Monako, Hollanda, Portugalia, Rumania, Sllovakia, Sllovenia, Spanja, Suedia, Zvicra, Mbretëria e Bashkuar e Britanisë së Madhe dhe Irlandës Veriore-8% ulje
- SH.B.A. -7% ulje
- Kanada, Hungari, Japoni, Poloni -6% ulje
- Kroaci -5% ulje
- Zelanda e Re, Federata Ruse, Ukrainë 0
- Norvegji + 1% ngritje
- Australi + 8% ngritje
- Islanda + 10% ngritje.¹²²

Protokolli i Kiotos lejon që palët e Aneksit I të shtojnë ose zbresin nga shuma e tyre fillestare e caktuar, duke ngritur ose ulur nivelin e tyre. Emetimet e lejuara gjatë periudhës së angazhimit, duke tregtuar njësitë e Kiotos me palët e tjera. Këto zvogëlime ose kufizime, kryhen në përputhje me të ashtuquajturit mekanizma të Kiotos:

- Tregtimi i emetimeve sipas nenit 17;
- Zbatimi i përbashkët (JI) sipas nenit 6;
- Mekanizmi i zhvillimit të pastër (CDM) sipas nenit 12.

Kapitulli IV - Raporti mes pronësisë intelektuale, teknologjisë dhe ndryshimeve klimatike

4.1 Pronësia intelektuale dhe teknologjitë pastërta (green technologies)

Shekulli 21 paraqitet të jetë shekulli në të cilën bota po lufton për të ruajtar dhe shpëtuar natyrën nga efektet serë të cilat kryesisht shkaktohen nga vetë njeriu. Paraqiten dy opsione për ta ruajtuar dhe shpëtuar mjedisin tone, edhe atë: revulicon në stilin e jetës apo një revolucion teknologjik.

¹²¹ United Nations Climate change / Process and meetings / The Kyoto Protocol /What is the Kyoto Protocol?
https://unfccc.int/kyoto_protocol

¹²² https://unfccc.int/resource/docs/publications/08_unfccc_kp_ref_manual.pdf

Me opsionin e parë nënkuptojmë kufizim i aktiviteteve njerëzore duke ndryshuar stilet e jetës. Populli mund të zgjedh që të përdorë energji të rinovueshme dhe të kufizoj çdo udhëtim të panevojshëm si dhe të favorizohen produktet e ricikluara. Mirëpo nëqoftëse ecim nga kjo rrugë, mund të mos kemi rezultate të dëshirueshme, pasi paraqitemi si diktator para popullit, duke komanduar çdo sjellje të tyre.

Opsioni i dytë është teknologjia. Kjo zgjidhje konsiston në kryerjen e kërkimeve në metodat teknike për të mbrojtur mjedisin tonë pa zvogëluar domosdoshmërisht aktivitetin njerëzor. Duket të jetë opsion më realist dhe humanist, pasi bazohet në bindjen se intelegjenca dhe përpjekja do të na mundësojnë të zbulojmë teknikën për një problem i cili është po aq teknik në vetvete.¹²³

Përdorimi i teknologjive të gjelbra duhet të jetë i shpejtë dhe të shtrihet në të gjithë globin. Sfida është e trefishtë:

- inkurajimi i inovacionit në fushën e teknologjive të gjelbra,
- promovimin e shpërndarjes së këtyre teknologjive dhe nxitjen e konsumatorëve për të favorizuar produktet dhe shërbimet që integrojnë teknologji të tilla,
- lejimi i transferimit të teknologjive të gjelbra në rajone të botës që nuk kanë mjetet për të investuar.

Për të arritur te një ekonomi të gjelbërt, kemi në vecanti ligjin për patentat që është celës i revolucionit të gjelbërt. Pyetja është nëse rregulloret aktuale që rregullojnë ligjin e pronës intelektuale dhe më posaçërisht ligjin e patentave ka të ngjarë të arrijnë objektivat tona të inkurajimit të inovacionit, shpërndarjes së teknologjive të gjelbra dhe transferimit të teknologjive të gjelbërta, ose nëse, përkundrazi, ato tani duhet të ndryshohen. Teknologjitë e gjelbërta janë ato teknologji të cilat na lejojnë të kufizojmë ngrohjen globale të shkaktuar si rezultat i emetimeve të gazrave serrë (GHG), duke përfshirë fushat e mëposhtme:

- ato teknologji të cilat na lejojnë të kursejmë energji;
- burimet e reja të energjisë (era, dielli, biomasa, etj.);
- teknologjitë për të filtruar dhe shfrytëzuar emetimet e CO₂.

Përkufizimin mund ta ndajme me një dallim të teknologjive, edhe atë: teknologjitë e adaptimit dhe teknologjitë e konvertimit.

Teknologjitë e adaptimit na lejojnë të përshtatemi në transformimet mjedisore, përshebull, kjo kategori na mundëson të kapërcejmë rreziqet e përmbytjeve të shkaktuara nga ngrohja globale. Kjo kategori nuk e zgjedh problemin, por e kompenson atë.

¹²³ Guillaume HENRY Doctor in Law Attorney at Law Specialized in Intellectual Property Law Lawfirm Gaultier Lakits Szleper 12, rue Lincoln 75008 Paris – FRANCE/ Intellectual Property Rights and Green Technologies

Teknologjitë e konvertimit - Kjo kategori synon të zvogëlojë ndikimin e veprimtarisë njerëzore në mjedis dhe për këtë arsye shfaq progres nga perspektiva mjedisore. Teknologjitë e aplikuara në format e energjisë së rinovueshme (era, biomasa, fotovoltaike), teknologjitë e kapjes së karbonit ose ato që zvogëlojnë konsumin e makinave dhe pajisjeve kanë efektin e kufizimit të dëmtimit të mjedisit krahasuar me teknologjitë e mëparshme. Pastrimi i ujit, zëvendësimi i plehrave biologjikë me plehra kimikë ose zvogëlimi i konsumit të ujit në bujqësi ose industri, për shembull, janë përfshirë në këtë përkufizim.

Në kontekstin e çështjeve në lidhje me të drejtat e pronës intelektuale dhe teknologjitë e gjelbra, qëllimi është që të hulumtohen ligjet më efektive të mundshme në mënyrë që të arrihet një ulje e emetimeve të gazeve serë. Sistemi aktual të patentave duhet të vlerësohet në bazë të tre sfidave kryesore, të cilat janë:

- (1) për të inkurajuar lojtarët kryesorë ekonomikë që të mbështesin inovacionin "e gjelbër",
- (2) që të promovojnë shpërndarjen e teknologjive "të gjelbërta" në të gjitha produktet dhe shërbimet, dhe
- (3) për të lejuar vendet në zhvillim të kenë qasje në këto teknologji.¹²⁴

Prona intelektuale që duhet të inkurajojë bizneset të investojnë më tej në kërkimin e teknologjive të gjelbra. Pyetja atëherë është të dish nëse këto shpikje të gjelbërta ose patenta të gjelbërta duhet t'i nënshtrohen një sistemi të veçantë, duke ndjekur shembullin e patentave farmaceutike. Bizneset private e kanë rolin kryesorë në inovacionin e gjelbër, për shkak të krizes aktuale ekonomike botërore, qeveritë e kanë shumë të vështirë të mobilizojnë shumën e mëdha parash, adaj fokusi kryesor për inovacion duhet të qëndroj brenda bizneseve private.

Institui Chatham House vlerësoi periudhën kohore që duhet të arrij deri te shpikjet e teknologjisë së gjelbërt, mesatarisht mendohet të jetë 20 deri në 30 vjet për të arritur në tregun masiv. Mirëpo institute konkludoi se kjo periudhë kohore duhet të përgjysmohet në mënyrë që të ketë një shans për të arritur objektivat fikse në lidhje me ndryshimin e klimës.¹²⁵

Grupet e patentave ose bashkësitë e patentave janë një faktor pothuajse unanimitisht i njohur në shpërndarjen e teknologjive. Suksesi i tyre varet nga numri i bizneseve pjesëmarrëse dhe portofoli i patentave që zotëron komuniteti. Makineria ndërkombëtare e biznesit nisi një sistem të ndarjes së patentave i cili u pa si idobishëm për mjedisin. Qëllimi i komunitetit ishte të ndante njohuri dhe patenta të cilat sjellin një përfitim direkt për mjedis dhe lejojnë një ulje të konsumimit të energjisë, parandalim të ndotjes së ajrit dhe reciklimit. Anëtarët e këtij komunitet

¹²⁴ Guillaume HENRY Doctor in Law Attorney at Law Specialized in Intellectual Property Law Lawfirm Gaultier Lakits Szleper 12, rue Lincoln 75008 Paris – FRANCE/ Intellectual Property Rights and Green Technologies

¹²⁵B. Lee, L. Lliev and F. Preston, Who owns our low carbon future ? Intellectual property and energy technologies, Chatham House, September 2009, p. vii

ishin Nokia, Sony, Dupont, Xerox dhe Bosch. Nokia, prezantoi një patentë për riciklim të telefonave celularë.¹²⁶

Çdo biznes pjesëmarrës, si dhe çdo palë e tretë ka qasje të lirë në këtë dhe nuk kërkohet asnjë regjistrim ose njoftim për të përdorur patentat e komunitetit. Në fushën e teknologjive të gjelbra, në mënyrë që të jenë efektive, komunitetet e patentave duhet të përqendrohen në një teknologji të veçantë: era, energjitë diellore, kapja e karbonit, etj. Shpërndarja e teknologjisë së gjelbërt nuk duhet të bëhet vetëm në vendet perëndimore të zhvilluara, por edhe në pjesë tjera më të varfra të botës.

Për shembull, një brez i ri i turbinës me erë është shpikur nga një kompani franceze. Mban patenta në Evropë, Shtetet e Bashkuara, Japoni, Kinë, Mozambik dhe Brazil. Nëse kompania franceze ka lehtësi të mjaftueshme prodhimi ose nëse i jep të drejta prodhimi dhe tregtimi vendeve të zhvilluara, shpërndarja e kësaj teknologjie duhet të jetë efektive në këto vende. Nga ana tjetër, çmimet e ngarkuara mund të vërtetojnë se janë shumë të shtrenjta për tregjet kineze, braziliane dhe Mozambikane. Nëse kompania franceze refuzon të ulë (ose nuk mund të ulë) çmimet e saj, veçanërisht sepse kostot e prodhimit për turbinën në Francë janë shumë të larta, disa vende mund të mos jenë në gjendje të përdorin këtë teknologji.¹²⁷

Sipas vlerësimeve, vendet e zhvilluara janë historikisht përgjegjëse për 77% të emisioneve totale që nga mesi i Shekullit 18. Sot, situata është e ndryshme pasi që, në 2004, vendet e zhvilluara ishin përgjegjëse për "vetëm" 59% të emetimeve. Në 2007, Kina u bë burimi kryesor i emetimeve. Ndarja e përpjekjeve për të zvogëluar emetimet duhet të arbitrojë midis përgjegjësive "historike" të vendeve të zhvilluara që tani kanë mjetet financiare për të reaguar ndaj sfidës së teknologjive të gjelbërta dhe vendeve në zhvillim që nuk duan të hendikepojnë zhvillimin e tyre ekonomik, por që, që nga viti 2007, kanë qenë duke kontribuar në shumicën e shkarkimeve. - Për sa u përket vendeve në zhvillim, ata pohojnë se çështja kërkon shpërndarjen falas të teknologjive.¹²⁸

Si konkluzion mund të thuhet sistemi për paraqitjen e shpikjeve të gjelbërta mund të modifikohet, veçanërisht përmes përsheptimit të proceseve të ekzaminimit, dhe ndoshta uljes së taksave dhe anuiteteve totale, inkurimi i mbajtësit të patentave që të autorizojnë palët e treta që të përdorin teknologjinë e tyre dhe transferimi i teknologjive të gjelbra në vendet në zhvillim e siper.

¹²⁶ The list of patents is available on the site www.wbcsd.org. See in particular : J. Reichman, A. Rai, G. Newell and J. Wiener, Intellectual Property and Alternatives : Strategies for Green Innovation, report 08/03 Chatham House, December 2008, p. 21.

¹²⁷ The list of patents is available on the site www.wbcsd.org. See in particular : J. Reichman, A. Rai, G. Newell and J. Wiener, Intellectual Property and Alternatives : Strategies for Green Innovation, report 08/03 Chatham House, December 2008, p. 21

¹²⁸ The list of patents is available on the site www.wbcsd.org. See in particular : J. Reichman, A. Rai, G. Newell and J. Wiener, Intellectual Property and Alternatives : Strategies for Green Innovation, report 08/03 Chatham House, December 2008, p. 21

4.2 Teknologjitë që mundësojnë gjenerimin e energjisë së ripërtritshme

Energjia e rinovueshme prodhohet duke përdorur burime natyrore të cilat vazhdimisht zëvendësohen dhe nuk harxhohen kurrë. Këto burime natyrore janë: biomasa, gjeoterma, hidrocentralet, fuqia oqeanike, diellore (termike fotovoltaike dhe diellore), era dhe hidrogjeni, të cilat mundësohen nga dielli direkt ose indirekt. Teknologjia e gjelbër merret me përdorimin e shkencës dhe teknologjisë me qëllim që të mbrojë mjedisin dhe siguron që mjedisi të mbetet i mbrojtur. Kjo teknologji merret për ta rringjallur përsëri ekosistemin tone të dëmtuar.

